

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS

BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT



Programi mësimor

GJUHË SHQIPE

për klasën VIII

Shkup, 2025

TË DHËNA THEMELORE PËR PROGRAMIN MËSIMOR

Lënda mësimore	Gjuhë shqipe
Lloji/kategoria e lëndës mësimore	E detyrueshme
Klasa	VIII (e tetë)
Temat/fushat e programit mësimor	- Gjuhë dhe komunikim - Letërsi, të shprehurit dhe krijimtari - Njohuri mediatike
Numri i orëve mësimore	4 orë në javë / 144 orë në vit
Pajisjet dhe mjetet	- Pajisjet teknike në klasë: tabelë elektronike, tabelë e shkollës, teknologji kompjuterike, printer. - Mjetet dhe burimet për të mësuar: fotografi, ilustrime me figura që kanë të bëjnë me përmbajtjet dhe veprimtaritë, plakate, afishe letrare, skema dhe paraqitje të ndryshme nga materiali mësimor, panele që ndjekin materialin sipas fushave programore; fjalorë, fjalorë drejtshkrimor, leksikon, enciklopedi, libra, programe/softvere edukative, regjistrime të rrëfimeve, regjistrime audio-vizuale; - Bibliotekë me libra në klasë, bibliotekë e shkollës, bibliotekë mediatike. Shënim: Nëse mësimi realizohet në kabinet, rekomandohet organizim i një këndi të dramës, një këndi artistiko-letrar, një këndi për gazetari, një vendi të përshtatshëm për bibliotekë në klasë.
Normativi për kuadrin mësimor	Mësimdhënjen e lëndë së gjuhës shqipe në klasën e VIII të arsimit fillor nëntëvjeçar mund ta realizojë personi që ka kryer drejtimin arsimor të programit studimor: Gjuhë dhe letërsi shqipe - VII/1 ose VI A, 240 kredi* <i>* Sipas Ligjit për mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesional në shkollat fillore dhe të mesme, Neni 10, paragrafi (3): “Kur në shpalljen publike nga paragrafi (1) i këtij neni, do të paraqiten më shumë kandidatë, përparësi u jepet mësimdhënësve që kanë shkallë më të lartë të arsimit të lartë përkatës dhe sukses më të lartë gjatë studimeve deridiplomike”.</i>

NDËRLIDHJA ME STANDARDET NACIONALE

Rezultatet e të nxënit të dhëna në programin mësimor shpjen në përvetësimin e kompetencave të mëposhtme të përfshira në fushën: **Njohuri gjuhësore**

<i>Nxënësi/nxënësjë di dhe mund:</i>	
I-A.1	t'i shprehë dhe t'i transmetojë mendimet, ndjenjat, informacionin dhe qëndrimet e veta në situata të ndryshme komunikimi në gjuhën e vet amtare, nëpërmjet medimeve të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme;
I-A.2	t'i njohë e t'i shfrytëzojë format e ndryshme të shprehjes me shkrim: ato letrare (vjersha, tregimi i shkurtër, prezantimi / të folurit, eseja (sprova) letrare, ditari etj.) dhe ato joletare (eseja tematike, njoftimi, kërkesa, komunikata, reklama etj.);
I-A.3	të zhvillojë dialog kritik e konstruktiv duke i paraqitur qëndrimet e veta në mënyrë të argumentuar;
I-A.4	të përdorë gjuhën standarde duke iu përmbajtur rregullave gramatikore dhe drejtshkrimore gjatë të shprehurit me gojë dhe me shkrim;
I-A.6	të identifikojë veçoritë themelore të gjuhës amtare (alfabetin, historinë, dialektet etj.), si dhe ngjashmëritë e dallimet e saj me gjuhët e tjera;
I-A.7	të identifikojë autorët dhe veprat më të rëndësishme të letërsisë në gjuhën amtare;
I-A.8	të kuptojë përmbajtjen e mesazheve dëgjimore: të jetë në gjendje t'i shkëpusë, t'i analizojë, t'i vlerësojë dhe t'i përmbledhë informacionet nga mesazhet dhe t'i shprehë ato (me shkrim dhe me gojë) me fjalët e veta;
I-A.9	të kuptojë përmbajtjen e një teksti të shkruar: të jetë i aftë të veçojë, të analizojë, të vlerësojë dhe të përmbledhë informacionin nga teksti dhe ta shprehë atë (me shkrim dhe me gojë) me fjalët e veta;
I-A.10	t'i kuptojë përmbajtjet e paraqitura vizualisht (diagramë, tabela e grafikë, ilustrime, filma vizatimorë etj.): të jetë në gjendje t'i ndajë, t'i analizojë, t'i vlerësojë dhe t'i përmbledhë përmbajtjet e shfaqura vizualisht dhe t'i sqarojë ato (me shkrim dhe me gojë);
I-A.11	t'i identifikojë e t'i analizojë mesazhet dhe elementet stilistike e estetike të veprave letrare;
I-A.12	të shfrytëzojë informacione nga burime dhe medie të ndryshme dhe t'u qaset atyre në mënyrë kritike, duke marrë parasysh burimin, kontekstin, qëllimin dhe besueshmërinë e informacioneve të paraqitura.
<i>Nxënësi/nxënësjë kupton dhe pranon se:</i>	
I-B.1	nëpërmjet mësimin të gjuhës amtare zhvillohet identiteti i vet gjuhësor e kulturor, ndërsa nëpërmjet komunikimit gjuhësor përcillet trashëgimia kulturore dhe kultura e të jetuarit;
I-B.2	me përdorimin e gjuhës në kontekste e mjedise të ndryshme dhe në forma të ndryshme mundësohet komunikimi dhe ndërveprimi efikas (gjithmonë duke pasur parasysh se me kë bëhet komunikimi);
I-B.3	gjatë leximit të teksteve me përmbajtje dhe me strukturë të ndryshme, zhvillohet shkrim-leximi, formohet një këndvështrim më i gjerë për veten dhe për botën dhe kështu nxitet të shkruarit nga domosdoshmëria dhe me kënaqësi;
I-B.4	përmbajtja dhe mënyra e shprehjes së mendimit personal mund të kontribuojë për të mbajtur e për të përmirësuar komunikimin, por edhe të shkaktojnë mosmarrëveshje e konflikte;
I-B.5	leximi dhe të shprehurit në gjuhën amtare janë të rëndësishme për zhvillimin dhe nxitjen e krijimtarisë dhe të të menduarit kritik;
I-B.6	njohja e gjuhës amtare është baza e të mësuarit dhe përvetësimit të njohurive në të gjitha fushat e tjera (lëndët mësimore);
I-B.7	njohja e gjuhës amtare është një ndër shtyllat më të rëndësishme të identitetit etnik.

Programi mësimor përfshin edhe kompetencat relevante të këtyre fushave të Standardeve nacionale: **Njohuri digjitale, Zhvillim personal dhe social, Shoqëri dhe kulturë demokratike, Teknikë, teknologji dhe sipërmarrje dhe Të shprehurit artistik dhe kulturë.**

IV. Njohuri digjitale

<i>Nxënësi/nxënësjë di dhe mund:</i>	
IV-A.1	të hulumtojë dhe krahasojë mundësitë e pajisjeve digjitale të njohura dhe të reja dhe të vlerësojë, të përzgjedhë dhe të përdorë në mënyrë të pavarur ato që janë më të përshtatshme për një nevojë dhe një situatë konkrete;
IV-A.2	të vlerësojë se për të zgjidhur një detyrë/problem kur dhe si është e nevojshme ta shfrytëzojë TIK-un në mënyrë efektive dhe efikase, të zgjedhë dhe të instalojë programet që i nevojiten, të përdorë programe mbrojtëse dhe të zgjidh problemet rutinë për funksionimin e pajisjeve dhe rrjeteve digjitale;
IV-A.3	të përdorë mënyra të ndryshme të organizimit, të ruajtjes së sigurt dhe të shpërndarjes së përmbajtjeve në pajisje dhe në rrjete të ndryshme në hapësirën digjitale;
IV-A.4	në bashkëpunim me të tjerët, të analizojë një problem, të zhvillojë ide dhe plan për hulumtimin dhe zgjidhjen e tij dhe të planifikojë kur dhe për çfarë do të përdorë TIK-un.
IV-A.5	të përcaktojë se çfarë informacionesh i duhen që t'i gjejë, t'i përzgjedhë dhe t'i shkarkojë të dhënat, informatat dhe përmbajtjet digjitale dhe të vlerësojë rëndësinë e tyre në raport me kërkesën konkrete dhe besueshmërinë e burimit;
IV-A.6	të zgjedhë dhe të përdorë mjete të ndryshme për përpunimin e të dhënave, t'i analizojë të dhënat dhe t'i prezantojë ato në mënyra të ndryshme duke i respektuar rregullat e përdorimit;
IV-A.7	të zgjedhë e të përdorë mjetet adekuate të TIK-ut për komunikim, të këmbejë informacione në mënyrë të sigurt, të kontaktojë e të bashkëpunojnë me të tjerët në projekte online, në veprimtari sociale ose për nevojat e veta;
IV-A.8	t'i shfrytëzojë në mënyrë të sigurt e me përgjegjësi përmbajtjet digjitale, rrjetet arsimore e sociale dhe format digjitale;
IV-A.9	në komunikimin me të tjerët, në hapësirën digjitale multikulturore, i respekton pjesëmarrësit e ndryshëm dhe ndjek normat ligjore, kulturore dhe etike të sjelljes në hapësirën dixhitale;
IV-A.10	të kujdeset për identitetin, sigurinë dhe reputacionin e vet digjital dhe t'i përfillë politikat rreth privatësisë.
I-A.12	të hulumtojë mundësitë për përdorimin e modeleve dhe simulimeve të ndryshme, kombinimin e paraqitjes statike dhe dinamike, zë, tekst dhe imazhe për të modifikuar ose për të krijuar përmbajtje të thjeshta multimediale krijuese me një qëllim të caktuar dhe për një audiencë specifike;
IV-A.13	të përcaktojë kriteret për cilësinë e përmbajtjeve dhe zgjidhjeve digjitale, duke përfshirë risitë dhe përdorshmërinë e tyre.
<i>Nxënësi/nxënësjë kupton dhe pranon se:</i>	
IV-B.1	njohuritë digjitale janë të domosdoshme në jetën e përditshme - ato e bëjnë më të lehtë të nxënit, jetën dhe punën, i japin ndihmesë zgjerimit të komunikimit, kreativitetit dhe inovacionit dhe ofrojnë mundësi të ndryshme argëtimi;
IV-B.2	përdorimi i papërgjegjshëm dhe i papërshtatshëm i TIK-ut ka kufizime dhe mund të sjellë rreziqe për individin ose shoqërinë;
IV-B.3	potencialet e TIK-ut vazhdimisht rriten prandaj duhet të ndiqen dhe të përdoren, por gjithashtu duhet të ketë qëndrim kritik ndaj vërtetësisë, besueshmërisë dhe ndikimit të të dhënave dhe informacionit të disponueshëm përmes pajisjeve digjitale;
IV-B.4	në hapësirën digjitale është e rëndësishme të sigurohet mbrojtja e identitetit, e privatësisë dhe e sigurisë emocionale, të mos përdoret gjuha e urrejtjes e dhuna kibernetike dhe të përfillen rregullat e normat e komunikimit në komunitetet digjitale;
IV-B.5	informacionet e disponueshme në hapësirën digjitale duhet të përdoret në mënyrë etike, sipas rregullave të përcaktuara dhe për të mirën e njerëzve;

IV-B.6	duhet të respektohen të drejtat e pronësisë intelektuale të përmbajtjeve të disponueshme në rrjetet dixhitale.
--------	--

V. Zhvillim personal dhe social

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe mund:</i>	
V-A.2	të zgjedhë dhe të praktikojë aktivitete që sigurojnë zhvillimin dhe përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së tij/saj mendore dhe fizike;
V-A.3	të identifikojë komponentët e ndryshëm të identitetit të vet, i cili ndërtohet mbi bazën e përkatësisë së grupeve të ndryshme shoqërore (për shembull, identiteti gjinor, etnik dhe kombëtar) dhe rolet e ndryshme që ka në jetë (për shembull, nxënësi, djali/vajza) ;
V-A.4	të bëjë vlerësimin e aftësive dhe arritjeve të veta (duke përfshirë anët e fuqishme dhe anët e dobëta) dhe mbi këtë bazë t'i përcaktojë përparësitë që do t'ia mundësojnë atij/asaj të zhvillohet e të përparojë;
V-A.5	të njohë emocionet e vetvetja dhe të tjerët, t'i kuptojë pasojat nga reagimet e veta emocionale në situata të ndryshme dhe të përdorë strategji përkatëse për t'u përballur me emocionet;
V-A.6	të përcaktojë qëllime të mësimin e të zhvillimit të vet dhe të punojë për kapërcimin e sfidave që i dalin para në rrugën e arritjes së tyre;
V-A.7	t'i shfrytëzojë përvojat personale për ta lehtësuar mësimnxënien dhe për ta përshtatur sjelljen e vet në të ardhmen;
V-A.8	të organizojë kohën në atë mënyrë që t'i mundësojë atij/asaj, në mënyrë efikase dhe efektive të arrijë qëllimet e përcaktuara dhe të kënaqë nevojat e veta;
V-A.9	të parashikojë pasojat e veprimeve të veta dhe të veprimeve të tjerëve për veten dhe për të tjerët;
V-A.10	të zbatojë parimet etike për të vlerësuar se ç'është e drejtë dhe ç'është gabuar në veprimet e veta dhe të tjerëve dhe të manifestojë vetitë e mira të karakterit (të tilla si: ndershmëria, drejtësia, respekti, durimi, kujdesi, mirësjellja, mirënjohja, vendosmëria, guximi dhe vetëdisiplina);
V-A.13	të komunikojë me të tjerët dhe të prezantojë veten në përshtatje me situatën;
V-A.14	të dëgjojë në mënyrë aktive dhe të reagojë në mënyrë adekuate, duke shprehur empati dhe mirëkuptim për të tjerët dhe t'i manifestojë në mënyrë konstruktive shqetësimet dhe nevojat e veta;
V-A.15	të bashkëpunojë me të tjerët për realizimin e qëllimeve të përbashkëta, duke ndarë pikëpamjet dhe nevojat e veta me të tjerët dhe duke i pasur parasysh pikëpamjet dhe nevojat e tjerëve;
V-A.17	të kërkojë informacion prapaveprues (feed back) dhe përkrahje për vete, por edhe të japë informacion prapaveprues konstruktiv dhe përkrahje në dobi të tjerëve;
V-A.18	të hulumtojë duke bërë pyetje përkatëse për të zbuluar problemet, të analizojë dhe të vlerësojë informatat, sugjerimet dhe të verifikojë supozimet;
V-A.19	të japë propozime, të shqyrtojë mundësi të ndryshme dhe t'i parashikojë pasojat me qëllim që të nxjerrë përfundime dhe të marrë vendime të arsyeshme;
V-A.21	të analizojë, të vlerësojë dhe të përmisojë të nxënësit.
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
V-B.1	kujdesi për trupin dhe praktikimi i rregullt i aktiviteteve fizike është kusht i rëndësishëm për të siguruar shëndet të mirë fizik dhe mendor;
V-B.2	njohja e identitetit personal kontribuon në forcimin e vetëbesimit dhe zhvillimin e personalitetit;
V-B.3	arritjet dhe mirëqenia e tij/e saj në masë të madhe varen nga puna që bën ai/ajo dhe nga rezultatet që i arrin ai/ajo;
V-B.4	çdo hap që ndërmerr është me pasoja për të dhe/ose për mjedisin e tij/e saj;

V-B.6	suksesi në jetë varet kryesisht nga qëllimet që ai i vendos vetes, ndërsa efikasiteti dhe efektiviteti në arritjen e qëllimeve të vendosura varet kryesisht nga mënyra se si ai/ajo i planifikon aktivitetet e tij/saj dhe se si e organizon kohën;
V-B.7	marrja e iniciativës, këmbëngulja, qëndrueshmëria dhe përgjegjësia janë të rëndësishme për zbatimin e detyrave, për arritjen e qëllimeve dhe për kapërcimin e sfidave në situatat e përditshme;
V-B.8	ndërveprimi me të tjerët është i dyanshëm - ashtu si ka të drejtë t'u kërkojë të tjerëve që t'ia mundësojnë atij/asaj t'i përmbushë interesat dhe nevojat e veta, gjithashtu ka edhe përgjegjësi t'u japë hapësirë të tjerëve për të përmbushur interesat dhe nevojat e tij/e saj personale;
V-B.9	kërkimi i informacioneve prapavepruese dhe pranimi i kritikës konstruktive çon drejt përparimit në planin individual dhe shoqëror.
V-B.10	të mësuarit është proces i vazhdueshëm që nuk përfundon në shkollë dhe nuk kufizohet vetëm në arsimin formal.

VI. Shoqëri dhe kulturë demokratike

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe mund:</i>	
VI-A.3	t'i formulojë e t'i argumentojë pikëpamjet e veta, t'i dëgjojë me vëmendje e t'i analizojë pikëpamjet e të tjerëve dhe të sillet me respekt ndaj tyre, madje edhe atëherë kur nuk pajtohet me to;
VI-A.5	t'i kuptojë dallimet midis njerëzve mbi çfarëdo qoftë baze (përkatësi gjinore dhe etnike, moshë, aftësi, status shoqëror, orientim seksual, etj.);
VI-A.6	të vërejë paraqitjen e stereotipave dhe paragjytimeve të vetja e të tjerët dhe t'i kundërvihet diskriminimit;
VI-A.7	të vërejë shfaqjen e dhunës verbale dhe fizike në mjedisin që e rrethon, t'i kuptojë pasojat e dhunës dhe t'i kundërvihet asaj;
VI-A.8	të kuptojë se çfarë i bashkon dhe çfarë i ndan njerëzit në komunitet, të gjejë mënyra për të kontribuar në përparimin e komunitetit, duke marrë parasysh nevojat dhe interesat e të gjithëve;
VI-A.9	të njohë grupet e pambrojtura (vulnerabël) në shoqëri të marrë pjesë në to dhe të mbështesë veprime humanitare dhe vullnetare;
VI-A.17	të analizojë ndikimin e mediave të shkruara, elektronike dhe sociale në opinionin publik dhe të zgjedhë burime të besueshme informacioni mbi të cilat do t'i bazojë pikëpamjet e veta.
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
VI-B.1	nuk duhet të diskriminojë njerëzit në bazë të dallimeve (përkatësi gjinore dhe etnike, moshë, aftësi ndryshe, status social, orientimi seksual, etj.);
VI-B.2	të gjithë njerëzit, përfshirë fëmijët, kanë të drejtë të shprehin mendimet dhe pikëpamjet e tyre dhe të marrin pjesë në vendimmarrje në lidhje me nevojat dhe interesat e tyre;
VI-B.5	barazia dhe kohezioni social janë të nevojshme për funksionimin e suksesshëm të komunitetit;
VI-B.6	angazhimi personal dhe bashkëpunimi me të tjerët janë çështje thelbësore për realizimin e interesit të përbashkët publik.

VII. Teknikë, teknologji dhe sipërmarrje

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe mund:</i>	
VII-A.2	të shpjegojë nevojën për inovacion për zhvillimin e shoqërisë;
VII-A.4	të gjenerojë ide dhe të krijojë aktivitete që çojnë në prodhim dhe/ose në shërbime;

VII-A.9	të marrë pjesë aktive në punën ekipore sipas rregullave të miratuara paraprakisht dhe duke respektuar denjësisht rolin dhe ndihmesën e të gjithë anëtarëve të ekipit;
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
VII-B.3	Iniciativa për bërë diçka është kushti thelbësor për të bërë ndryshime në jetën personale dhe jetën në komunitet, dhe suksesi i ndryshimeve lidhet me përballimin e sfidave dhe/ose marrjen e rreziqeve;
VII-B.4	etika e punës, ndjeshmëria kulturore dhe sjellja ndaj të tjerëve janë të rëndësishme për krijimin dhe ruajtjen e një klime pozitive pune;
VII-B.5	burimet nuk janë të pakufizuara dhe duhet të përdoren me përgjegjësi.

VII. Të shprehurit artistik dhe kulturë

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe mund:</i>	
VIII-A.1	të tregojë se i njeh format e ndryshme të shprehjes artistike në të gjitha fushat e kulturës (letërsi, muzikë, arte vizuale, arte skenike, arte dekorative, arkitekturë, dizajn);
VIII-A.2	të identifikojë manifestimet e ndryshme të kulturës popullore dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e vlerave estetike;
VIII-A.3	t'i shprehë idetë, përvojat dhe emocionet e veta duke shfrytëzuar format artistike ose format e tjera të të shprehurit krijues (individuale ose kolektive);
VIII-A.4	të interpretojë idetë, përvojat dhe emocionet e shprehura në krijimet artistike të bëra nga të tjerët që janë pjesëtarë të kulturës së vet ose të kulturave të tjera;
VIII-A.5	të tregojë se e njeh kulturën e vet dhe mënyrat e ndryshme të shprehjes së saj nëpërmjet letërsisë dhe arteve vizuale, muzikës dhe vallëzimit, ndërtimeve dhe prodhimeve të tjera kulturore;
VIII-A.6	të identifikojë dallimet dhe ngjashmëritë midis kulturës së vet dhe kulturave të tjera në mjedisin e ngushtë e të gjerë dhe të analizojë lidhjet dhe ndërvarësitë reciproke të tyre;
VIII-A.7	të njohë dhe të shpjegojë se si aspektet kulturore ndryshojnë me kalimin e kohës dhe në kontekste të ndryshme;
VIII-A.8	të njohë rëndësinë dhe të shpjegojë përfitimet dhe sfidat e globalizimit dhe lidhjen e çështjeve lokale me lëvizjet globale;
VIII-A.9	të njohë dhe të shpjegojë se si kultura së cilës i përket (përfshirë traditën dhe fenë) ka ndikuar në formimin e identitetit dhe botëkuptimit të tij/saj;
VIII-A.10	të identifikojë dhe të shqyrojë stereotipet dhe paragjykimet ndaj anëtarëve të grupeve të tjera kulturore që shfaqen në mjedisin e tij/saj.
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
VIII-B.3	respektimi dhe promovimi i kulturës së vet kontribuon në forcimin e identitetit dhe dinjitetit kulturor;
VIII-B.5	dallimet ndërmjet kulturave duhet të shihen si mundësi për të mësuar dhe si sfidë për mirëkuptim dhe përparim të ndërsjellë;
VIII-B.6	respektimi dhe promovimi i kulturave të tjera kontribuon që edhe kultura e vet të respektohet nga të tjerët.

REZULTATET E TË NXËNIT

Fusha programore: **GJUHË DHE KOMUNIKIM**

Gjithsej: 67 orë

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi/nxënësjë do të jetë i/e aftë:

1. të identifikojë pozitën e gjuhës shqipe si gjuhë indo-evropiane brenda trungut gjenealogjik gjuhësor;
2. të tregojë intelektualët shqiptarë dhe hartuesit e parë të teksteve normative dhe ta shpjegojë rëndësinë e tyre për zhvillimin e gjuhës shqipe;
3. të njohë, të dallojë dhe përdorë intonacionin e duhur në fjalitë sipas kumtimit;
4. të njohë dhe të tregojë shembuj të foljeve me kuptim të plotë, të foljeve me kuptim modal (gjysmëndihmëse);
5. të njohë dhe të formojë kohët e përbëra foljore (më se e kryera; e kryera e tejshkuar; e ardhmja e së shkuarës; e ardhmja e përparme; e ardhmja e përparme e së shkuarës), duke përdorur kuptimet e tyre themelore;
6. të formojë trajta të mënyrës dëshirore dhe urdhërore dhe të shpjegojë kuptimin e tyre me shembuj përkatës;
7. të formojë dhe të zbatojë në një kontekst të përshtatshëm strukturat me foljet ndihmëse **jam** dhe **kam**;
8. të veçojë, të përcaktojë dhe të ilustrojë gjymtyrrët e dyta të fjalisë;
9. të dallojë dhe të ndërtojë fjali njëkryegjymtyrëshe në kontekst të duhur;
10. të tregojë dhe të thotë me shembuj përdorimin dhe rolin e çdo pjese të pandryshueshme të ligjëratës;
11. të dallojë dhe të shpjegojë marrëdhëniet e pjesëve të fjalisë së përbërë dhe të përdorë saktë presjen në fjalitë e përbëra me bashkërenditje;
12. të interpretojë kuptimin e fjalëve me burim të gjuhës shqipe dhe të fjalëve të huaja dhe t'i përdorë ato drejt në kontekst;
13. të lexojë me të kuptuar tekste komplekse dhe të gjata dhe të lexojë e të interpretojë tekste jolineare.

Përmbajtjet (dhe nocionet/konceptet):

Shkenca për gjuhën

- Gjuha shqipe në familjen e gjuhëve indo-evropiane (indishtja, iranishtja, armenishtja, greqishtja, shqipja, gjuhët italiane, gjuhët kelte, gjuhët gjermanike, gjuhët baltike e gjuhët sllave)

Standardet e vlerësimit:

- Interpretin termin „gjuhë indo-evropiane“ në kontekstin e zhvillimit të përbashkët historik të gjuhëve që i përkasin kësaj familjeje gjuhësore.
- Tregojnë familjen e gjuhëve, së cilës i përket gjuha shqipe.
- Lidh grupet e gjuhëve të familjes së gjuhëve indo-evropiane me popujt që i flasin ato.

Zhvillimi historik i gjuhës shqipe Gjuha shqipe në shekujt XVIII dhe XIX (Rilindja Kombëtare, Ëvetari i Naum Veqilharxhit, “Shoqata e të shtypurit shkronja shqip”, gramatikat e para me synime normative, Kostandin Kristoforidhi)	- Krahason pikëpamjet e rilindësve për gjuhën Shqipe. - E kupton rëndësinë e gjuhës së rilindësve të shekulli XIX për zhvillimin e gjuhës së njësuar shqipe. - Krahason qëndrimet e rilindësve lidhur me zhvillimin e gjuhës shqipe. - Konstaton rëndësinë e gjuhës së përfaqësuesve të Rilindjes Kombëtare për zhvillimin e gjuhës standarde.
Fonetika dhe rregullat drejtshkrimore të zanoreve dhe bashkëtingëlloreve Zanoret dhe bashkëtingëlloret - Zanoret <i>e</i> dhe <i>ë</i>, zanorja <i>u</i>, grupet e zanoreve - Takimi i bashkëtingëlloreve (<i>g</i> me <i>j</i> (<i>djegje</i>), <i>d</i> me <i>t</i> (<i>dyqindtë</i>) ose <i>t</i> me <i>sh</i> (<i>U rritsh</i>), <i>l</i> me <i>ll</i> (<i>dembellëk</i>) dhe <i>r</i> me <i>rr</i> (<i>përreth</i>); takimi i dy bashkëtingëlloreve të njëjta (<i>kënddrejtë</i>); grupet e bashkëtingëlloreve (<i>mb, nd, ng, ngj</i>) Intonacioni - Shqiptimi i llojeve të ndryshme të fjalisë me intonacion të ndryshëm (fjali dëftore, fjali pyetëse, fjali nxitëse, fjali thirrmore)	- Shkruan dhe shqipton drejt zanoret e dhe <i>ë</i> dhe grupet e zanoreve. - Shkruan dhe shqipton drejt grupet e bashkëtingëlloreve (<i>mb, nd, ng, ngj</i>). - Shkruan dhe shqipton drejt bashkëtingëlloret <i>g</i> dhe <i>j</i>, <i>d</i> dhe <i>t</i>, <i>t</i> dhe <i>sh</i>, <i>l</i> dhe <i>ll</i> dhe <i>r</i> dhe <i>rr</i> kur ato takohen. - Shkruan dhe shqipton drejt takimin e bashkëtingëlloreve të njëjta. - Identifikon ndërrimet fonetike gjatë takimit të bashkëtingëlloreve dhe jep shembuj për to. - Shqipton dhe shkruan drejt bashkëtingëlloret <i>d</i> dhe <i>t</i> kur takohen me bashkëtingëlloren <i>sh</i>: <i>dsh, tsh</i>. - Identifikon intonacionin e fjalive të ndryshme. - Përdor intonacionin e duhur për fjalitë dëftore, pyetëse, nxitëse dhe thirrmore. - Lexon dhe përdor intonacionin e duhur për fjalitë përkatëse.
Morfologjia - Mbiemrat marrëdhëniorë (<i>i/e</i> parë, <i>i/e</i> dytë, <i>i/e</i> tretë) - Përemrat dëftorë (<i>i/e</i> këtyllë, <i>i/e</i> atillë, të këtyllë, të atillë, <i>i/e</i> tillë, të tillë) - Foljet me kuptim të plotë, foljet me kuptim modal (gjysmëndihmëse), foljet ndihmëse, foljet këpujore - Kategoria gramatikore e mënyrës të foljet (mënyra dëftore; mënyra lidhore; mënyra dëshirore, mënyra urdhërore) Pjesët e pandryshueshme të ligjëratës - Lidhëzat	- Krahason përemrat dëftorë dhe mbiemrat marrëdhëniorë dhe tregon mënyrën e formimit të tyre. - Tregon kontekste shembujsh/fjalish për përdorimin e mbiemrave marrëdhëniorë. - Shpjegon dallimet mes përemrave dëftorë (<i>i/e</i> atillë) dhe mbiemrave marrëdhëniorë (<i>i/e</i> parë) dhe jep shembuj të përdorimit të tyre kur ata emërzohen. - Shpjegon mënyrën e formimit të mbiemrave marrëdhëniorë dhe të përemrave dëftorë. - Interpreton kategoritë gramatikore të mbiemrave marrëdhëniorë dhe të përemrave dëftorë. - Identifikon foljet sipas kuptimit të tyre: foljet me kuptim të plotë, foljet me kuptim modal (gjysmëndihmëse). - Njeh dhe tregon shembuj të foljeve me kuptim të plotë, të foljeve me kuptim modal (gjysmëndihmëse).

- Parafjalët
- Pasthirrmat
- Pjesëzat

Kohët e përbëra të foljeve

- Më se e kryera (kisha + pjesorja); e kryera e tejshkuar (pata + pjesorja)
- E ardhmja e së shkuarës; e ardhmja e përparme; e ardhmja e përparme e së shkuarës (kuptimi themelor dhe mënyra e formimit)
- Kohët e përbëra të foljeve (folja ndihmëse **jam**, folja ndihmëse **kam**)

- Tregon dallimet mes foljeve me kuptim të plotë, foljeve me kuptim modal (gjysmëndihmëse).
- Jep shembuj të përdorimit të foljeve me kuptim të plotë, të foljeve me kuptim modal (gjysmëndihmëse).
- Njeh fjalitë dëftore, nxitëse dhe dëshirore.
- Interpreton mënyrën dëftore si neutrale, njoftim neutral për ndonjë veprim apo gjendje.
- Njeh mënyrën dëftore sipas kontekstit të fjalisë.
- Tregon shembuj fjalish me qëndrim neutral (mënyra dëftore) dhe me qëndrim të folësit (mënyra dëshirore dhe mënyra urdhërore).
- Njeh dhe tregon shembuj të trajtave foljes të mënyrës dëshirore dhe të mënyrës urdhërore.
- Shpjegon kuptimin dhe trajtat e foljeve të mënyrës dëshirore dhe të mënyrës urdhërore me shembuj përkatës.
- Njeh pjesët e pandryshueshme të ligjëratës dhe kupton rëndësinë e tyre gjatë komunikimit. Njeh lidhëzat sipas strukturës së tyre.
- Përdor lidhëza të thjeshta, të përngjitura dhe lokucione lidhëzore.
- Përdor parafjalët dhe njeh përdorimin e tyre në fjali.
- Njeh përdorimin e pasthirrmave në fjali dhe i përdor ato në mënyrë adekuate.
- Njeh përdorimin e pjesëzave në fjali dhe në disa ndërtime gramatikore.
- Dallon kohët e përbëra të foljeve.
- Njeh trajtat e foljeve për kohën më se të kryer dhe për të kryerën e tejshkuar.
- Formon trajta të foljeve për kohën më se të kryer dhe të kryerën e tejshkuar dhe mund të shpjegojë mënyrën e formimit të tyre.
- Përdor drejt (me shkrim dhe me gojë) trajtat foljore për kohën më se të kryer dhe të kryerën e tejshkuar.
- Formon trajta për kohën e ardhme të së shkuarës dhe të së ardhmes së përparme dhe për kuptimin e tyre mohor.
- Tregon shembuj për kohën e ardhme të së shkuarës dhe të së ardhmes së përparme dhe për kuptimin e tyre themelor.
- Njeh trajtat e foljeve për kohën e ardhme të përparme të së shkuarës.
- Përdor drejt (me shkrim dhe me gojë) trajtat foljore për kohën e ardhme të së shkuarës, të së ardhmes së përparme dhe të ardhmen e përparme të së shkuarës.

	• Identifikon ngjashmëritë dhe dallimet e kohëve të ardhme në fjali (tekst) dhe shpjegon çfarë kanë të përbashkët këto trajta foljore, nëpërmjet të krahasimit të kuptimeve të tyre. • Bën dallim mes ndërtimeve sintaksore me foljet ndihmëse jam dhe kam. • Ndërton struktura me foljet ndihmëse jam dhe kam. • Përdor drejt dhe në mënyrë adekuate këto ndërtime kur shprehet me gojë dhe me shkrim.
Sintaksa • Kundrinori – rimarrja e kundrinorit (rimarrja e kundrinorit të drejtë dhe e kundrinorit të zhdrejtë pa parafjalë, trajtat e shkurtra të përemrit vetor, kundrinori i zhdrejtë me parafjalë) • Gjymtyrët e dyta të fjalisë – përcaktori dhe ndajshtimi (përcaktori dhe ndajshtimi) • Fjalët e ndërmjetme • Fjalitë njëkryegjymtyrëshe (fjali njëkryegjymtyrëshe me gjymtyrë kryesore të shprehur me folje: vetore dhe pavetore – <i>Veson.</i>, me folje pësore në vetën e tretë njëjës dhe me një ndajfolje a emër – <i>Nuk jetohet kështu</i>. Dhe kur shoqërohet me trajtat e shkurtra të përemrave vetorë shprehin gjendjen e brendshme psiko-fizike – <i>Më flihet.</i>; me folje fjali njëkryegjymtyrëshe me gjymtyrë kryesore të shprehur me emër: emër a grup emëror në rasën emërore – <i>Dimër. Natë vjeshte.</i>) • Struktura e fjalisë së përbërë (periudhës) (fjalë e përbërë, pjesët e fjalisë së përbërë, fjalë e përbërë me bashkërenditje, fjalë e përbërë me nënrenditje) • Fjalitë e përbëra me bashkërenditje (fjalë e përbërë me bashkërenditje; këpujore, kundërshtore, veçuese, përmbyllëse)	• Njeh rimarrjen e kundrinorit dhe e shpjegon me shembull. • Njeh rimarrjen e kundrinorit të drejtë dhe të kundrinorit të zhdrejtë pa parafjalë. • Dallon kundrinorin e zhdrejtë me parafjalë nga kundrinorët e tjerë. • Shpjegon dallimin mes kundrinorit të zhdrejtë me parafjalë dhe rrethanorit. • Shpjegon termin gjymtyrë e dytë e fjalisë në kontekst të rëndësisë së tyre në fjali. • Njeh përcaktorin dhe ndajshtimin. • Jep shembuj me përcaktor dhe ndajshtim. • Njeh dhe përdor fjalët e ndërmjetme në komunikimin me gojë dhe me shkrim. • Shpjegon se fjalët e ndërmjetme dhe pasthirrmat janë jashtë lidhjeve sintaksore, do të thotë nuk janë gjymtyrë fjalie. • Njeh dhe ndërton fjali njëkryegjymtyrëshe. • Shpjegon strukturën e fjalisë së përbërë. • Dallon pjesët e fjalisë së përbërë. • Njeh raportin e pjesëve të fjalisë në një fjali të përbërë, e bashkërenditur dhe të nënrenditur. • Njeh dhe dallon fjalitë e përbëra me bashkërenditje sipas kuptimit. • Ndërton lloje të ndryshme të fjalive të përbëra me bashkërenditje, duke përdorur lidhëzat dhe lokucionet lidhëzore, si dhe presjen në këto fjali.

Leksiku Leksiku i gjuhës shqipe sipas prejardhjes së fjalëve (fjalë të burimit të shqipes, fjalë të huazuara; ndërkombëtarizmat, anglicizmat, orientalizmat, barbarizmat)	- Identifikon dhe interpreton kuptimin e fjalëve të burimit të shqipes dhe të atyre të huaja në shembuj të dhënë. - Jep shembuj, në të cilët përdor fjalë të leksikut të gjuhës shqipe, që kanë prejardhje të ndryshme.
Rregullat drejtshkrimore - Presja në fjalinë e thjeshtë (numërimi, përsëritja, veçimi) - Presja në fjalitë e përbëra me bashkërenditje	- Përdor drejt presjen në kuadër të fjalive të thjeshta (numërimi, përsëritja, veçimi). - Përdor drejt presjen në fjalitë e përbëra me bashkërenditje.
Të lexuarit me të kuptuar - Të lexuarit me të kuptuar i teksteve të gjata dhe komplekse - Të lexuarit dhe interpretimi i teksteve komplekse dhe jolineare	- U përgjigjet pyetjeve të parashtruara lidhur me një tekst të lexuar. - Identifikon dhe shpreh faktet, detajet dhe ngjarjet e paraqitura në një tekst të caktuar letrar dhe joletrar. - Shpjegon fjalë ose shprehje të panjohura në një tekst të caktuar sipas përdorimit të tyre në kontekst. - Nxjerr fjalët kyçe nga një tekst i lexuar në bazë të të cilave përmbledh tekstin. - Nxjerr përfundime logjike bazuar në provat dhe informacionet e dhëna në një tekst. - Bën parashikime për atë që mund të ndodhë më pas në tekst bazuar në të asaj që ka kuptuar për personazhet, thurja dhe kontekstin. - Identifikon raportin shkak-pasojë në një tekst dhe nxjerr përfundimin se si ngjarjet ose veprimet ndikojnë njëra-tjetrën. - Bën pyetje rreth një teksti letrar ose joletrar të lexuar për ta kuptuar atë dhe për të nxjerrë përfundime për mesazhin ose qëllimin e autorit të tekstit. - Përdor citate, shembuj ose detaje si dëshmi (prova) për të mbështetur përfundimet që nxjerr lidhur me një tekst të lexuar. - Lexon dhe interpreton legjenda, tabela, grafikë dhe tekste të tjera jolineare më komplekse.

Shembuj veprimtarish (aktivitetesh):

- Nxënësit punojnë në grupe të vogla. Mësimdhënësi/ja u shpërndan grupeve materialin e leximit. Nxënësit lexojnë pjesë nga veprat e shkrimtarëve rilindës të shekullit XIX. Për shembull, lexohen fragmente të shkurtra prej 2-3 fjalish nga *"Gjahu i malësorëve"* të Kostandin Kristoforidhit, nga *"Bagëti e bujqësi"* të Naim Frashërit etj. Diskutohet tema dhe përmbajtja e fragmenteve, gjuha në të cilën janë shkruar, shpjegohen fjalët e panjohura dhe nxirren përfundime, të cilat shkruhen nën çdo fragment.
- Veprimtarët shqiptarë vendosen në një bosht kohor të shekujve XVIII dhe XIX. Nxënësit lexojnë pjesë të shkurtra nga disa vepra dhe kanë për detyrë të identifikojnë autorin e fragmentit bazuar në gjuhën në të cilën janë shkruar ato pjesë. Për shembull, ata lexojnë pjesë nga poezitë *"Himni i flamurit"* dhe *"Vaje"*, kuptojnë se janë shkruar në gjuhën popullore. Pastaj ata shënojnë autorin në afatin kohor. Procedura përsëritet për të gjithë fragmentet dhe autorët. Në fund nxënësit përmbledhin përgjigjet e tyre të vendosura në boshtin kohor lidhur me përdorimin e gjuhës shqipe në shekujt XVIII dhe XIX.
- Nxënësit luajnë role *"Kush jam unë?"*, pas përgatitjes së mëparshme të dhënë si detyrë shtëpie nga mësimdhënësi/ja. Një nxënës luan një person të caktuar nga shekujt XVIII dhe XIX (p.sh. Naum Veqilharxhi, Kostandin Kristoforidhi, Naim Frashëri, Asdreni, etj.) pa u treguar nxënësve të tjerë se kush është, ai paraqet kuptimin, veprat dhe pikëpamjet e tij për gjuhën në të cilën ai shkruan. Për shembull, rrëfimi rrjedh në këtë mënyrë: Veprat e mia janë: *"Bagëti e bujqësi"* (1886) *"Istoria e Skënderbeut"* (1898), *"Qerbelaja"* (1898). Në *"Gjuha jonë"* unë kam shkruar – *"Vëllezër shqiptarë, Të prekim urtësinë, Të zëm' udhën e mbarë, Të ngjallim Shqipërinë... O burra, shqipëtarë, Të marrim dituritë, Se s'është koh' e parë, Tani lipsetë dritë... Gjuha jonë sa e mirë! Sa e ëmbël sa e gjerë, Sa e lehtë sa e lirë, Sa e bukur sa e vlerë!"*; pastaj, në vitin 1886 unë kam shkruar edhe poemën *"Bagëti e bujqësi"*. Unë shquhem si një nga përfaqësuesit më të denjë të letërsisë së Rilindje Kombëtare Shqiptare... Kush jam unë? Nxënësit supozojnë se është Naim Frashëri. I njëjti parim paraqitet për autorë të ndryshëm nga shekujve XVIII dhe XIX. Nxënësit shënojnë individualisht pikëpamjet e teksteve për zgjedhjen e gjuhës standarde, i diskutojnë ato sipas orientimeve të dhëna, duke bërë krahasime specifike, shkruajnë ngjashmëritë dhe dallimet në lidhje me pikëpamjet e teksteve.
- Nxënësit punojnë në çifte. Mësimdhënësi/ja i jep secilit çift një fletë pune. Çiftet marrin një tekst në të cilin ka fjalë, që përmbajnë bashkëtingëllore ose grupe bashkëtingëlloresh të shkruajtura gabimisht. Për shembull, teksti i mëposhtëm mund të funksionojë për grupet bashkëtingëllore *mb* dhe *nd*: *Mrëmë na erdhën mysafirë. Ata trokitën në derë, por gjyshja nuk i ngjoi. Kështu ata për një kohë metën jashtë. Kur më në fun ua hapëm derën, ata pyetën pse ne gjithnjë e mbajmë derë myllur. Ne u treguam se kështu mund t'i niejmë më mirë ata që vijnë, pasi ata detyrohen të trokasin.* Nxënësit nënvizojnë me të kuqe fjalët e shkruara gabim në tekst, duke i kushtuar vëmendje bashkëtingëlloreve dhe grupeve të bashkëtingëlloreve. Pastaj i shkruajnë ato drejt. Prezantojnë punën para gjithë klasës duke shpjeguar shkrimin dhe shqiptimin e grupit bashkëtingëllor përkatës. Nga teksti janë këto fjalë: *mrëmë - mbrëmë, ngjoi - dëgjoi, metën - mbetën, fun - fund, mbyllur - mbyllur, niejmë - ndiejmë.* Me po këtë parim, mund të bëhen detyra me shembuj të ndryshëm fjalësh me bashkëtingëllore, grupe bashkëtingëlloresh dhe bashkëtingëllore të njëjta që takohen e ku ka dyfishim ose rënie të bashkëtingëlloreve.
- Nxënësit punojnë në grupe. Çdo grup merr një tekst me lloje të ndryshme të fjalive. Nxënësit lexojnë tekstin dhe përdorin intonacionin e duhur për fjalitë përkatëse. Kurse pastaj në tabelë i shënojnë llojet e fjalive sipas intonacionit. Secili grup prezanton punën dhe jep komente për pyetjet e shokëve të klasës dhe mësimdhënësit/es në lidhje me intonacionin e fjalisë.
- Nxënësve, të ndarë në grupe, u jepet një tekst i shkurtër me mbiemra marrëdhëniorë dhe me përemra dëftorë (*i/e atillë*). Ata e lexojnë tekstin dhe në tabelë i shkruajnë mbiemrat marrëdhëniorë në një kolonë, kurse përemrat dëftorë (*i/e atillë*) në një kolonë tjetër. Ata vërejnë dallimin dhe

e komentojnë përdorimin e tyre. P.sh.: "Në një klasë nxënësit ishin reshtuar. Nxënësi **i parë** qëndronte me trupin drejt, Pas tij rrinte një vajzë me bluzë të kuqe. Një bluzë **të tillë** kam edhe unë. Nxënësja **e tretë** qëndronte disi e menduar. Ajo është **e tillë** – gjithnjë ëndërron ...".

- Nxënësve u jepet një fletë pune me tekst në të cilin ka përemra dëftorë dhe mbiemra marrëdhëniorë. Mësimdhënësi/ja u jep udhëzim që fillimisht të lexojnë tekstin dhe më pas duhet t'i ndajnë përemrat dëftorë nga mbiemrat marrëdhëniorë. Ata bëjnë një tabelë me dy kolona. Në njërën kolonë i shkruajnë përemrat dëftorë: *i, e tillë, i, e këtillë*, ndërsa në kolonën tjetër i shkruajnë mbiemrat marrëdhëniorë: *i, e parë, i, e dytë, i, e tretë*. Ata e shohin ndryshimin dhe komentojnë përdorimin e tyre. Nga shembujt e zgjedhur të mbiemrave marrëdhëniorë: ata formojnë fjali dhe komentojnë kuptimin e tyre në fjali, duke nxjerrë përfundim për kuptimin e përemrave dëftorë dhe mbiemrave marrëdhëniorë.
- Nxënësit ndahen në çifte. Çiftet mes vete tregojnë nga pesë folje. Për detyrë kanë që t'i shkruajnë foljet në fletore dhe të formojnë fjali. Nxënësit pasi t'i shkruajnë fjalitë do të tregojnë se foljet që janë shkruar janë: folje me kuptim të plotë, me kuptim modal (gjysmëndihmëse), folje ndihmëse, folje këputore. Pas leximit të fjalive nxënësit do të sjellin përfundim se cilat janë kategoritë e tyre gramatikore. Përfundimet shkruhen në dërrasë të zezë.
- Nxënësit ndahen në grupe me nga 4-5 nxënës. Atyre u jepen ngjitëse/stikera në të cilat janë shkruar shembuj me folje. Secili grup duhet të shkruajë një fjali me foljen e dhënë në ngjitësen/në stikerin, në të cilën do të tregojë qëndrimin e folësit ndaj veprimit të shprehur me folje (në mënyrën dëftore, lidhore, dëshirore dhe urdhërore - secili grup i jepet folje në një mënyrë të caktuar). Pastaj me ato folje secili grup duhet t'i shndërrojë fjalitë në mënyrat e tjera, të ndryshme nga mënyra që i ka qëlluar në ngjitëse. Më pas nxënësit diskutojnë për mënyrën se si shprehet veprimi i foljes, kur përdorim mënyrën dëftore, kur mënyrën dëshirore dhe kur atë urdhërore. Nga fjalitë e dhëna nxënësit do ta shohin se si ndryshon folja dhe si formohen trajtat e foljeve sipas kategorisë gramatikore të mënyrës. Nxënësit i shkruajnë rregullat në fletoret e tyre.
- Nxënësit kanë karta – të gjelbra dhe të kuqe. Një nxënës tërheq një kartë me fjalë të shkruar paraprakisht. Nxënësit e tjerë ngrenë kartonin e kuq, nëse fjala është e pjesë e ndryshueshme e ligjëratës dhe e ngrenë kartonin e gjelbër nëse fjala është pjesë e pandryshueshme e ligjëratës. Mësimdhënësi/ja ndjek punën e nxënësve dhe u jep shpjegime nxënësve që ngrenë ngjyrën e gabuar të kartës.
- Nxënësit ndahen në grupe. Secili grup merr një kuti me fjalë dhe një fletë pune me një tabelë, në të cilën janë dhënë kolona ku janë shënuar pjesët e pandryshueshme të ligjëratës (lidhëza, para-fjalë, pasthirrma dhe pjesëza). Detyra e nxënësve është të bëjnë radhitjen e fjalëve që nxjerrin nga kutia nëpër kolonat përkatëse. Grupi që kryen detyrën i pari dhe saktë, del fitues dhe prezanton punën e bërë. Të tjerët ndjekin dhe nëse është e nevojshme, bëjnë korrigjime në tabelat e tyre.
- Nxënësve u jepen fjalë të shkruara në letër. Në tabelë janë të vizatuara pesë kuti. Në çdo kuti shkruhet një pjesë e pandryshueshme e ligjëratës. Nxënësit duhet t'i vendosin fjalët, aty ku mendojnë se përkasin. Më pas, kuti pas kutie, kontrollohen të gjitha fjalët dhe diskutohet a është bërë shpërndarja e duhur e fjalëve nëpër kuti.
- Nxënësit marrin fletë pune me disa pasthirrma. Më pas formojnë fjali nga pasthirrmat e dhëna duke treguar se çka shprehin ato: *o, oho, të lumtë, urra (ndjenja të gëzuara), boba, kuku, obobo (frikë, tmerr), au, oj, ua, (habi), ...etj.* Në fund nxënësit punojnë në çifte duke formuar fjali nga pasthirrmat e dhëna. Disa çifte shkruajnë në tabelë shembujt e fjalive me pasthirrmat, mësimdhënësi/ja dëgjon përgjigjet e tyre, me pjesën tjetër të nxënësve, komenton përdorimin e pasthirrmave.
- Mësimdhënësi/ja u jep për detyrë nxënësve të ndërtojnë fjali, në të cilat do të përdorin fjalë dhe togje të ndërmjetme për të shprehur: shkallën e vërtetësisë, vlerësimin emocional, qëndrimin e folësit, burimin e kumtimit etj... fjalitë e krijuara nxënësit i shkruajnë në tabelë duke shpeguar

qëndrimin e folësit ndaj asaj që thotë. Si motivim për ndërtimin e fjalive, mësimdhënësi/ja mund t'i orientojë, që shembujt t'i marrin nga situata reale, nga ngjarje konkrete ose nga jeta në shkollë.

- Nxënësit ndahen në katër grupe. Secilit grup i jepet nga pesë lidhëza. Dy grupe ndërtojnë fjali të përbëra, në të cilat lidhëzat do të përdoren për të lidhur pjesët e fjalisë. Dy grupet e tjera përdorin lidhëzat për të lidhur dy fjalë brenda fjalisë së thjeshtë. Në fund të orës lexohen fjalitë dhe nxirren përfundimet me ndihmën e mësimdhënësit/es për funksionin e lidhëzave në fjali.
- Nxënësit punojnë në çifte. Çdo çifti i jepet një fletë, në të cilën ka një strip si organizues grafik, me ndihmën e të cilit duhet të zhvillohet biseda mes çiftit. Në retë e zbrazëta nxënësit duhet të shkruajnë atë që flasin. Detyra është që njëri personazh nga stripi të dijë ndonjë informacion (i cili është shkruar në fletë), të cilin duhet t'ia përcjellë personazhit tjetër, duke përdorur kohën e ardhme të së shkuarës. Për shembull, për informacionin: *“Anila do të shkojë për pushimin dimëror në Kodrën e Diellit”*, personazhi i parë thotë: *“Motra ime më tha se Anila **do të shkonte** për pushimin dimëror në Kodrën e Diellit”*.
- Dy nxënës dalin në dërrasë të zezë dhe luajnë role. Ata përfaqësojnë dy gjyshe të ulura para një porte që bisedojnë me zë të ulët. Më pas nxënësve u jepet nga një fletë prej kutisë së përgatitur më parë, ku fjalitë janë shkruar në kohën e ardhme ose në të ardhmen e përparme të së shkuarës. “Gjyshja” e parë e lexon fjalinë që foljen e ka në kohën e ardhme, për shembull: *Nesër **do të bëjmë** dasmë*, kurse “gjyshja” tjetër e lexon po atë fjali duke e kthyer foljen në kohën e ardhme të përparme të së shkuarës: *Nesër **do të kishim bërë** dasmë*, dhe duke mohuar atë që thotë “gjyshja” e parë *Nesër **nuk do të bëjmë** dasmë* dhe *Nesër **nuk do të kishim bërë** dasmë*. Pastaj ata ndërrojnë rolet.
- Çdo nxënës merr shirit me një fjali. Në shembujt e dhënë, kërkohet që folja e dhënë të kthehet në kohën më se të kryer. Shembull: *Kur erdhi Agimi, ne e mbaruam punën. Kur erdhi Agimi, ne e **kishim mbaruar** punën*. Në tabelë vendosen shiritat me fjali, lexohen fjalitë, duke komentuar kuptimin e foljes dhe në cilat raste përdoret ajo.
- Nxënësve u jepet një fletë mësimore që përmban fjali me folje në kohën më se të kryer. Detyra e tyre është që t'i rishkruajnë ato, duke përdorur foljet ndihmëse **kam** dhe **jam**. Shembull: *Arta **ishte larë** në lumë. Arta **kishte larë** shumë enë. Ne i **kishim hapur** dritaret para se të ndodhte kjo. Dritaret **ishim hapur** para se të ndodhte kjo*.
- Nxënësit punojnë në çifte. Secilit çift i jepet një fletë pune ku kërkohet prej nxënësve të nënvizojnë ndërtimet me foljet ndihmëse **kam** dhe **jam**, si për shembull në fjalitë: *Unë **kam mësuar** për detyrat kontrolluese. Unë **kisha mësuar** për detyrat kontrolluese. Unë **pata mësuar** për detyrat kontrolluese. Unë **jam mësuar** të jem e qetë. Unë **isha mësuar** të jem e qetë. Unë **qeshë mësuar** të jem e qetë*. Ndërtimet me foljet ndihmëse **kam** dhe **jam** prezentohen para gjithë klasës, duke nxjerrë përfundime për rolin e tyre në ndërtimin e kohëve të përbëra të foljeve.
- Nxënësit punojnë në grupe të vogla. U jepet një tekst me fjali në të cilat janë përdor kundrinori i drejtë dhe kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë dhe kundrinori i zhdrejtë me parafjalë. Secili grup, aty ku është e nevojshme, duhet të përdorë trajtat e shkurtra të përemrave vetorë në funksion të rimarrjes së kundrinorit. Grupi i parë do të punojë për kundrinorin e drejtë. Shembull: *Ju ____ **(e)** fituat **ndeshjen** e rëndësishme. ____ **(E)** fituat me angazhimin tuaj. Gjuha ____ **(e)** bashkon **kombin**. Unë po ____ **(e)** marr **këtë**, kurse ti merre **atë***. Grupi i dytë do të punojë për kundrinorin e zhdrejtë pa parafjalë. Shembuj: ***Atij** ____ **(i)** erdhi keq për mësuesin. **Sportistëve** ____ **(u)** dhanë shpërblime dhe fletëlavdërime. Populli ____ **(i)** dha ndihmë **shkollës***. Grupi i tretë do të shkruajë për kundrinorin e zhdrejtë me parafjalë. Shembull: *Ata po flisnin **për miqtë** e tyre. Besa kujdesej shumë **për nënën** e saj. Në fund çdo grup paraqet punën e vet dhe tregon se me ç'pjesë të ligjëratës mund të shprehet kundrinori.*

- Nxënësit punojnë në grupe të vogla. Grupet marrin disa fjali në të cilat duhet të plotësojnë emrat e përdorur me disa përcaktorë të ndryshëm: të shprehur me emër, me mbiemër apo me ndajshim. Shembull: *Këto janë mollët e përmendura të Prespës. Drita e fortë na i verboi sytë. Nënë Tereza u shqua për bamirësi.*
- Nxënësit punojnë në grupe. Secili grup merr një tekst në të cilin duhet të nënvizojnë fjalitë njëkryegjymtyrëshe ku do të mungojë njëra nga gjymtyrët: P.sh grupi i parë do të gjejë fjalitë njëkryegjymtyrëshe të shprehur me emër apo grup emëror në rasën emërore: *Dimër. Natë vjeshte.* Grupi i dytë do të nënvizojnë fjalitë njëkryegjymtyrëshe ku do shprehin gjendjen e brendshme psiko-fizike: *Më flihet. Nuk më punohet.* Secili grup i shënon shembujt në dërrasën e zezë dhe tregon funksionin e tyre.
- Nxënësit punojnë në çifte. Çdo çifti i jepet një fletë pune në të cilën janë shkruar disa fjali të thjeshta. Nxënësit kanë për detyrë që nga dy fjali të thjeshta të ndërtojnë një fjalë të përbërë. Shembull: 1. *Anisa po kërkonte atletet e reja. / Nuk i gjeti. (Anisa i kërkonte atletet e reja, por nuk i gjeti).* 2. *Qeni e dëgjoi zërin e Altinit./Kërceu nga gëzimi. (Qeni e dëgjoi zërin e Altinit, prandaj kërceu nga gëzimi).* Pastaj fjalitë e përbëra i ndajnë në pjesët përbërëse të tyre. Ata diskutojnë për raportet e pjesëve të fjalive përbëra dhe tregojnë nëse pjesët janë të bashkërenditura apo të nënrenditura dhe shpjegojnë pse quhen kështu.
- Nxënësit punojnë në grupe të vogla. Secili grup duhet të ndërtojë fjalë të përbërë me bashkërenditje me të gjitha llojet e lidhëzave bashkërenditëse. Më pas ata kanë për detyrë të ndërtojnë sa më shumë lloje fjalësh të përbëra me bashkërenditje prej dy fjalive të thjeshta, duke përdorur lidhëza të ndryshme. Pas ndërtimit të fjalisë së përbërë me bashkërenditje, ata duhet të shkruajnë çfarë lloji është fjalia dhe të tregojnë kur dhe pse shkruhet presje në fjalinë përkatëse. Shembull:
Jo vetëm që nuk shkoi në punë, por as nuk u paraqit fare (Fjalë të përbërë me bashkërenditje shtuese)
O mëso si duhet, o lëri studimet. (Fjalë të përbërë me bashkërenditje veçuese)
E ëma e kishte dërguar të birin te një usta për të mësuar zanatin, mirëpo ustai nuk ia kishte mësuar as gjysmën e zanatit. (Fjalë të përbërë me bashkërenditje kundërshtore)
Ai mësoi tepër, prandaj u lodh shumë. (Fjalë të përbërë me bashkërenditje përmbyllëse)
- Nxënësit ndahen në grupe. Secilit grup i jepet një fletë pune ku janë dhënë disa fjalë, me të cilat nxënësit duhet të hartojnë një tekst të shkurtër ku do të përdoren të gjitha fjalët e dhëna. Më pas grupet kanë për detyrë të zëvendësojnë fjalët e shkruara me sinonime përkatëse. Shembull: *kadia - gjykatësi, madam - zonjë, sebp- arsye, dhaskal - mësues...* Punën e bërë ata e vendosin në tablo ose i ngjitin fletët në dërrasën e zezë për të parë kuptimet e fjalëve në kontekste të ndryshme.
- Nxënësve u jepet një fletë mësimore në të cilën janë shkruar rregullat drejtshkimore për përdorimin e presjes si shenjë e pikësimit. Më poshtë në fletë janë shkruar fjali në të cilat nuk është përdorur presja. Nxënësit kanë për detyrë të përdorin presjen aty ku mendojnë se duhet të përdoret, duke ndjekur udhëzimin me rregullat e drejtshkimit të mësipërm. Mësimdhënësi/ja shënon në dërrasën e zezë përgjigjet e sakta dhe së bashku me nxënësit komentohen përgjigjet e tyre nga fletët e punuara në përputhshmëri me rregullat e treguara drejtshkimore.
- Nxënësit ndahen në grupe, secilit grup i jepen fjali të thjeshta dhe lidhëza që përdoren në fjalitë e përbëra me bashkërenditje. Ata kanë për detyrë të ndërtojnë fjalë, por të kenë kujdes në përdorimin e presjes në përputhje me rregullat e përdorimit të presjes ndërmjet pjesëve të fjalisë së përbërë me bashkërenditje.
- Nxënësit ndahen në grupe. Secilit prej grupeve i jepet teksti i njëjtë që përmban të dhëna të reja e të panjohura nga më parë. Teksti mund të jetë gazetaresk. Në bazë të përmbajtjes, duke analizuar informacionet, ata zbulojnë informacione të fshehura. Përdorin pyetjet themelore për zbulimin e tekstit: *kush, çfarë, kur, si, pse.* Më pas e ndajnë tekstin në paragrafë dhe nxjerrin informacionin themelor. I lidhin informacionet themelore dhe

marrin pasqyrën e përgjithshme të kuptimit të tekstit dhe informacionit të paraqitur. Nxënësit zbulojnë ngadalë edhe informacionin që nuk paraqitet si fakt. Grupi që zbulon të gjitha informacionet e fshehura është fitues.

- Nxënësve u jepet një tekst me përmbajtje historike. Ata e lexojnë atë dhe kanë për detyrë të nxjerrin argumentet e paraqitura nga autori. Më pas, në bazë të argumenteve nxjerrin përfundime për periudhën që flitet në tekst. Për shembull, teksti jep informacion për rrethanat socio-politike në Maqedoninë e Veriut gjatë Perandorisë Osmane dhe për pozitën e gruas në atë kohë. Nxënësit nxjerrin argumente, prova, citate dhe krijojnë qëndrimet e tyre në lidhje me atë që kanë lexuar. Të gjitha këto i paraqesin para klasës.
- Nxënësit ndahen në grupe të vogla. Secilit grup i jepet nga një abstrakt (përmbledhje) nga një tekst me material prej lëndëve të tjera mësimore. Për shembull, u jepet një tekst që paraqet përmbajtje dhe nocione nga lënda e biologjisë (*Ekologjia - mirëmbajtja e ekosistemit*). Ata e lexojnë tekstin në mënyrë të pavarur dhe më pas identifikojnë fjalët dhe shprehjet kyçe. Me ndihmën e fjalëve dhe shprehjeve kyçe përpiqen ta paraqesin temën para të gjithëve.
- Nxënësit punojnë në grupe. Atyre u jepet tekst nga ndonjë blog. Për detyrë kanë të diskutojnë atë që kanë lexuar dhe të nxjerrin pikat e rëndësishme nga teksti në një fletë. Nxënësve u kërkohet të lexojnë tekstin në mënyrë kritike dhe të kontrollojnë rëndësinë e tij duke analizuar grafikonet, tabelat dhe diagramet e paraqitura së bashku me tekstin. Për informacionin e paraqitur, ata u përgjigjen pyetjeve të përgatitura nga mësimdhënësi/ja. Së bashku kontrollojnë saktësinë e informacionit të paraqitur në formën e citateve, detajeve si dëshmi dhe shembuj të tjerë për të mbështetur përfundimet nga teksti i lexuar.
- Nxënësve u jepet fletë mësimore nga një libër, për shembull "*Hobbit*", nga i cili është kopjuar një hartë. Harta rishikohet në grupe. Paraprakisht është përgatitur një tekst i shkurtër në të cilin është rrëfyer shkurt një pjesë e përmbajtjes së librit ku përmenden toponimet në hartë. Nxënësit duhet t'i gjejnë ato dhe të tregojnë se si ka lëvizur grupi për të cilin bëhet fjalë në tekst. Secili grup prezanton punën e bërë.
- Nxënësit punojnë në çift. Çdo çift lexon një tekst. Më pas, me teknikën e *Kubit*, u përgjigjen disa kërkesave që lidhen me përmbajtjen e tekstit: *përshkruaj, krahaso, asoco, analizo, apliko, argumento pro ose kundër*. Secili çift prezanton punën e bërë, mësimdhënësi/ja dhe nxënësit e tjerë japin komente për përfundimet e nxjerra.

Fusha programore: LETËRSI, TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIA

Gjithsej: 67 orë

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. të përmendë: mbledhës të veprave popullore, të antologjive dhe të llojeve të krijimtarive të përfaqësuara në antologji;
2. të dallojë poezinë e dashurisë sipas motivit;
3. të dallojë mjetet shprehëse stilistike (rima sipas vendit të theksit ritmik në fund të vargut, anafora, epifora, metafora, llojet e metaforës: emër, mbiemër dhe folje, paronomasia);
4. të përshkruajë karakteristikat e një tregimi fantastik dhe të bëjë dallimin midis një romani fantastik dhe një romani detektiv sipas përmbajtjes;
5. të shpjegojë dallimet ndërmjet autorit dhe rrëfimtari, autorit dhe personazhit, rrëfimtari të personazheve, llojeve të transmetuesve (rrëfimtari unë dhe ai);
6. të perceptojë fazat e një veprimi dramatik dhe të zgjidhë konfliktin në tekstin dramatik;

7. të interpretojë pjesë ose vepra të tëra letrare: poezi, prozë dhe dramë;
8. të shkruajë tekste me zbatim praktik; të përgatisë rrëfimin me gojë dhe me shkrim dhe ritregimin e përvojave; për të përgatitur një fjalim për një temë të caktuar ose të zgjedhur, me ose pa plan;
9. të shkruajë një ese duke respektuar rregullat për shkrimin e saj;
10. të debatojë me argumente për një temë që ai/ajo e njeh.

Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:

1. përmes leximit të teksteve me përmbajtje dhe strukturë të ndryshme zhvillohet shkrim-leximi, krijohet një pamje më e gjerë për veten dhe botën dhe nxitet të shkruarit nga nevoja dhe nga kënaqësia;
2. të lexuarit dhe të folurit në gjuhën shqipe janë të rëndësishme për zhvillimin dhe nxitjen e kreativitetit dhe të menduarit kritik.

Përmbajtjet (dhe nocionet/konceptet):	Standardet e vlerësimit:
Letërsia popullore Veprimtaria e mbledhësve të folklorit – të Jeronim De Radës, të Thimi Mitkos, të Dhimitër Kamardas (mbledhës, lloje të krijimeve të mbledhura, antologji)	- Numëron emrat e mbledhësve të veprave popullore. - Numëron llojet e veprave që gjenden në përmbledhjet e veprave popullore. - Shpjegon rëndësinë e mbledhësve të veprave popullore për zhvillimin e letërsisë shqiptare.
Lirika - Poezia e dashurisë - Mjetet shprehëse stilistike: rima sipas vendit të theksit ritmik në fund të vargut, anafora, epifora, paronomasia, metafora: metafora emër, mbiemër dhe folje.	- Parafrazon dhe interpreton përmbajtjen e vargjeve dhe ndjenjat e mendimet e shprehura nga një subjekt lirik. - Përcakton motivin dhe subjektin lirik në një poezi. - Përcakton rimën sipas vendit të theksit ritmik në fund të vargut: fundore (mashkullore), parafundore (femërore) dhe tejparafundore (rrëshqitëse). - Njih mjetet shprehëse stilistike në shembuj nga poezitë (anafora, epifora, metafora: metafora emër, mbiemër dhe folje dhe paronomasia). - Analizon poezitë lirike sipas motivit dhe shprehjes stilistike
Epika në prozë - Llojet e tregimeve të shkurtra sipas temës: Tregimi fantastik - Romani; Llojet e romanit sipas temës/përmbajtjes: roman fantastik, roman detektiv (gjatësia/vëllimi i rrëfimit, personazhet, veprimet, ngjarjet) - Rrëfyes/narrator: autor (dallimet: autor-rrëfyes -personazh, personazh-rrëfyes, llojet e rrëfyesit)	- Njih tregimin fantastik sipas temës, mënyrës së të rrëfyerit, personazheve, hapësirës dhe kohës së ngjarjes. - Shpjegon temën e një romani fantastik. - Zbulon dhe diskuton karakteristikat e një romani fantastik. - Shpjegon temën e një romani detektiv. - Tregon karakteristikat e romanit detektiv. - Interpreton citate të zgjedhura nga një tekst letrar (roman fantastik e detektiv dhe tregim fantastik), të treguara ose të zgjedhura sipas kriterëve të paracaktuara. - Dallon: autorin nga rrëfyesi, autorin nga personazhi, personazhin rrëfyes (narrator) dhe llojet e rrëfyesit (unë dhe ai tregimtar) në tekste konkrete në prozë.

Drama - Fazat e zhvillimit të veprimit dramatik: (paraqitja, thurja, kulminacioni, peripecia, shthurja; konflikti dramatik); - Llojet e dramës: tragjedia, komedia	- Shpjegon specifikat e dramës si gjini e veçantë letrare. - Gjen konfliktin dramatik në një tekst dramatik të lexuar. - Numëron dhe shpjegon fazat e veprimit dramatik. - Dallon komedinë dhe tragjedinë nga leximi i fragmenteve. - Interpreton citate të zgjedhura nga tekste dramatike.
Të shprehurit dhe krijimtaria - Të shkruarit e teksteve me zbatim praktik: letër në formë elektronike (mënyra e të shkruarit një letër elektronike, zyrtare dhe jozyrtare (private), kërkesë/lutje. - Tregimi dhe ritregimi - Hartimi i një fjalimi - Të shkruarit ese (zgjedhja e një titulli, vendosja e një teze, struktura e esesë - hyrje ose refererim për esenë përmes pyetjes kryesore për temën e zgjedhur; pjesa kryesore - përshkrimi i tezës, detajet, lidhja e fakteve dhe detajeve me idetë; pjesa përmbyllëse - përmbledhja e pikave kryesore, fjalja përmbyllëse me një mesazh) - Të shkruarit kreativ - Debati (tema, dyanshmëria, rregullat e debatit, argumentimi, moderatori, audienca, qëllimi)	- Shkruan një letër elektronike me qëllime të ndryshme, formale (zyrtare) dhe joformale (jozyrtare). - Shkruan lutje/kërkesë një personi zyrtar apo një institucioni. - Tregon dhe ritregon përvojat e veta dhe të të tjerëve. - Krijon fjalim, me gojë ose me shkrim, për një temë të caktuar ose të zgjedhur. - Krijon fjalim, me gojë ose me shkrim sipas një plani të dhënë ose të përgatitur vetë. - Shkruan ese duke respektuar rregullat e kompozimit për shkrimin e esesë. - Shprehet me shkrim (shkruan ese) për një tekst letrar të lexuar, duke paraqitur një mendim të mbështetur me citate. - Shkruan në mënyrë krijuese, duke zgjedhur motivin dhe formën e të shprehurit (tekst poetik ose prozë, ose dialog dramatik). - Shprehet në mënyrë krijuese me gojë dhe me shkrim duke përdorur mjete shprehëse stilistike që ka mësuar. - Tregon karakteristikat e debatit. - Përgatit argumente për debat për një temë të caktuar. - Shprehet me gojë dhe me shkrim, duke respektuar rregullat e drejtshqiptimit dhe të drejtshkrimit të gjuhës standarde shqipe.

Shembuj veprimtarish (aktivitetesh):

- Nxënësit ndahen në grupe dhe shikojnë përmbledhjet e përgatitura nga mësimdhënësi për mbledhësit e folklorit shqiptar. Ata analizojnë përmbajtjen e antologjive, klasifikimin e veprave, perceptojnë të dhënat bazë në lidhje me botimin e antologjisë dhe autorit apo redaktorit. Secili grup prezanton përmbledhjen/koleksionin e tij duke bërë një poster të vogël prej tij që mund të jetë një kujtesë për të mësuarit në klasë.
- Nxënësit ndahen në grupe. Secili grup ka për detyrë të zgjedhë një vepër nga përmbledhja e mbledhësve të folklorit dhe ta prezantojë atë në mënyrën e tij krijuese: nëse është këngë që ka versionin e saj muzikor/të kënduar, duhet ta këndojnë ose të krijojnë një koreografi për të, mund ta paraqesin veprën me një dramatizim në mënyrë të pavarur qoftë tregim apo poezi apo ta shndërrojnë përmbajtjen artistikisht në vizatim. Grupet gjatë prezantimit të punës së tyre tregojnë karakteristikat e veprës së tyre, nëse është poezi, tregim, anekdotë... dhe përcaktojnë motivin në to.
- Nxënësit punojnë të pavarur. Lexojnë një poezi dhe punojnë sipas teknikës *Tre çelësa dhe një bravë*. U kërkohet nxënësve të veçojnë tre elemente kyçe nga përmbajtja të cilat do t'i thonë me fjalët e tyre dhe do t'i parafrazojnë këta si *tre çelësa* të teknikës. Më pas kërkohet të nxirren citate nga poezia që konfirmojnë atë që është thënë, ky është në të vërtetë *brava* e teknikës. Pas punës së kryer në mënyrë të pavarur, ndahet puna e bërë me shkrim dhe nxirren përfundime për kuptimin e poezisë.
- Nxënësit lexojnë poezi të zgjedhura për dashurinë nga poetë të njohur shqiptarë. Ata kanë për detyrë të përcaktojnë motivin në poezi dhe në bazë të tij të përcaktojnë llojin e poezisë dhe më pas të komentojnë ndjenjat dhe mendimet e shprehura nga subjekti lirik. Për komentet lidhur me mendimet dhe ndjenjat e shprehura, nxënësit u përgjigjen pyetjeve të përgatitura më parë nga mësimdhënësi në përputhje me përmbajtjen e poezisë: Shembull: *Kujt i drejtohet subjekti lirik? Si e përshkruan poeti dashurinë? Çfarë ndjenjash shprehen ai këto vargje? Si e përjeton poeti dashurinë? Sipas diskutimit cili është motivi në poezi?*
- Nxënësit punojnë të pavarur. Në fletën mësimore janë shkruar pjesë nga vjersha në të cilat ka rima të ndryshme me numër të ndryshëm të rrokjeve që përbëjnë fjalët e rimuara dhe kanë dy tabela: njëra tabelë DDM (di/dua të di/mësova) dhe tjetra tabelë për llojet e reja të rimës që duhen mësuar. Nxënësve u jepen udhëzime që në tabelën DDM të shkruajnë çfarë dinë për rimën si mjet shprehës stilistik, nëse është gjithmonë e njëjtë dhe a dinë ta ndajnë atë sipas ndonjë kriteri. Më pas ata plotësojnë kolonën e dytë, domethënë shkruajnë çfarë tjetër duan të mësojnë rreth rimës. Nxënësit përqendrojnë punën e tyre te shembujt, i lexojnë ato dhe i ndajnë fjalët që rimohen. Rimat e ndara i klasifikojnë sipas numrit të rrokjeve që kanë, e më pas caktojnë se në cilën rrokje bie theksi . Më pas çdo rimë e vendosin në tabelën e vogël ku janë të shkruar emrat e llojeve të rimës rima sipas vendit të theksit ritmik në fund të vargut: **fundore** (mashkullore), **parafundore** (femërore) dhe **tejparafundore** (rrëshqitëse). Puna e bërë ndahet në klasë dhe kontrollohet në tabelë. Përfundimi i orës mësimore shkruhet në kolonën e tretë të tabelës DDM, dhe sqarohet se përveç rimave që kanë mësuar deri më tani (rima e përputhur, rima e kryqëzuar/alternuar, rima e përmbyllur), ekzistojnë edhe rima sipas vendit të theksit ritmik në fund të vargut, që janë **fundore** (mashkullore), **parafundore** (femërore) dhe **tejparafundore** (rrëshqitëse).
- Nxënësit lexojnë dhe krahasojnë në mënyrë të pavarur poezi në të cilat ka përsëritje të së njëjtës fjalë ose disa fjalë në fillim ose në fund të vargjeve. Nëpërmjet një bashkëbisedimi për kuptimin e vargjeve dhe funksionin e përsëritjes së tyre në fillim dhe në fund të vargjeve, shpjegohen mjetet stilistike shprehëse anafora dhe epifora dhe roli i tyre në poezi.

- Nxënësve u jepen shembuj metaforash dhe diskutojnë kuptimin e tyre: *reja shëtiti, dielli tregoi një histori, pylli u përplas në një përrua, nata lulëzoi, shpirt guri, ditë me ngjyra, zog i shkujdesur*. Mësimdhënësi/ja i orienton të analizojnë llojet e fjalëve që përbëjnë metaforën, duke kuptuar kuptimin e figurshëm të tyre. Nxënësit përfundojnë veprimtarinë me përfundimin se metafora mund të jetë emër (*shpirt guri, buzë mali*), *mbiemër (qiell i trishtë, dashuri i pastër) ose folje (nata lulëzoi, reja shëtit, rruga gjarpëron, qielli vajton)*.
- Nxënësve u jepen poezi të ndryshme ku përdoret figura e shqiptimit stilistik të paronomasisë. Ata përpiqen të gjejnë fjalët me përbërje tingujsh të ngjajshëm por me kuptim të ndryshëm. I shkruajnë fjalët e gjetura në tabelë dhe vërejnë tingujt e ngjashëm dhe kuptimin e ndryshëm që ka fjalia. Në fund përfundojnë se paronomasia është figure stilistike që krijohet duke vënë afër në një fjali ose në një varg dy fjali me përbërje tingujsh të ngjajshëm, por me kuptim të ndryshëm (shembull: *afroj-ofroj, luaj-shuaj*).
- Nxënësit punojnë në çifte, lexojnë një tregim të shkurtër me përmbajtje fantastike. Kur analizojnë tekstin përdorin teknikën e *Tabelës së Parashikimit*. Tabela përmban tri kolona, domethënë tri pyetje: *Çfarë mendoni se do të ndodhë?; Çfarë provash/dëshmish keni për këtë?; Çfarë ka ndodhur në të vërtetë?*. Teksti lexohet deri diku, plotësohen dy kolona, më pas vazhdohet leximi, më pas plotësohet kolona e tretë dhe sërish dy të parat, deri në fund të tregimit. Tregimet fantastike kanë vendndodhje dhe objekte të pazakonta, si dhe personazhe të tillë, kështu që parashikimi dhe përballja me ngjarje reale lë një dozë pasigurie që është karakteristika kryesore e këtij lloji të tregimeve. Pasi përfundojnë leximin e tregimit të shkurtër, nxënësit shkruajnë karakteristikat bazë që kanë perceptuar gjatë leximit: personazhet, ku, kur dhe çfarë ka ndodhur. Një person lexon atë që është shkruar me zë të lartë dhe të gjithë konfirmojnë ose korrigjojnë atë që është shkruar.
- Nxënësit lexojnë një romanin (sipas dëshirës ose me rekomandim të mësimdhënësit/es) me udhëzime të dhëna që më parë për lexim: sa dhe cilët personazhe takohen, cili personazh është personazhi kryesor dhe çfarë synon, kush e ndihmon dhe kush e kundërshton në arritjen e qëllimit të tij, sa kohë zhvillohen ngjarjet, sa ngjarjet ka, sa vendndodhje ndryshojnë, cilat ngjarje janë më të rëndësishmet në tekst, çfarë zgjedh të bëjë personazhi kryesor në momentet më të rëndësishme, cilat ide nga teksti mund të shohin përmes ngjarjeve dhe veprimeve specifike të personazheve në romanin. Pasi nxënësit, përmes diskutimit, janë përgjigjur për këto pyetje, shtrohet pyetja e radhës: *Çfarë është romani?*
- Nxënësit në çifte lexojnë fragmente nga i njëjti romani (në aktivitetin paraprak). Puna në çifte zhvillohet përmes teknikës *Parashtrimi i pyetjeve*, gjatë së cilës nxënësit do të mund të bëjnë pyetje faktike, pyetje për supozime dhe pyetje për nxjerrjen përfundimit. Në secilin çift, nxënësit lexojnë me radhë paragraf pas paragrafi. Pas çdo fragmenti, nxënësit i bëjnë tjetrit pyetje rreth asaj që lexojnë. Në fund të aktivitetit, nxënësit e secilit çift ndajnë përfundimet e tyre me gjithë klasën.
- Nxënësit ndahen në grupe. Secili grup merret vesh dhe zgjedh në mënyrë të pavarur një tekst për ta sjellë në klasë. Teksti në grup përpunohet sipas disa kërkesave: përshkrimi i përmbajtjes me disa fjali; analiza e tekstit duke kërkuar personazhet dhe karakteristikat e tyre, të përshkuara ose të perceptuara me veprime, duke mbështetur atë që paraqitet me citate; lidhja e veprimeve të personazheve me jetën reale; krahasimi dhe argumentimi i pikëpamjeve nëpërmjet citimeve mbështetëse. Secili grup prezanton punën e tij para klasës.
- Nxënësit lexojnë në mënyrë të pavarur citate të përzgjedhura nga romanet bashkëkohore me përmbajtje fantastike ose me përmbajtje detektive, (sipas dëshirës ose me rekomandim të mësimdhënësit/es). Citimet e përzgjedhura ilustrojnë temën dhe nxënësit kërkojnë rrëfyesin, a është rrëfyesi vetë personazhi, gjegjësisht nëse rrëfyesi është në vetën e parë *UNË* apo në vetën e tretë *AI/AJO*. Mësimdhënësi/ja nxit diskutimin dhe u kërkon nxënësve të kërkojnë *prova/dëshmi* në tekst se kush është rrëfyesi. Diskutimi mbyllet pasi nxënësit paraqesin argumentet për pretendimin e tyre dhe përfundojnë me mësimdhënësin/en se cili rrëfyes është i pranishëm në përmbajtjen e lexuar.

- Nxënësit lexojnë në shtëpi një nga lektyrat e caktuara. Gjatë leximit ata përdorin teknikën *Ditari i dyfishtë*, të cilin e plotësojnë sipas kërkesave për të nxjerrë citate përmes të cilave do të tregojnë se cilat ngjarje janë në etapën e paraqitjes së veprimit dramatik, cilat ngjarje janë thurja (ndërthurja), kulminacioni, peripecia dhe shthurja në tekstin dramatik. Për secilën etapë, nxënësit mbajnë shënime dhe shpjegojnë pse mendojnë se ajo etapë është pikërisht në atë pjesë të tekstit. Nxënësit, bazuar në leximin e tyre, shpjegojnë konfliktin dramatik. Të gjitha këto shënime që bëjnë gjatë leximit të pavarur prezantohen në klasë dhe diskutohen. Në fund nxirret përfundim, të cilin të gjithë e shkruajnë së bashku.
- Nxënësit diskutojnë për nocionet *komedi* dhe *tragjedi*. Shpjegimi i kuptimit bëhet përmes diskutimit, përmes *negociatave për kuptimin* të cilën e shkruajnë në tabelë. Më pas lexojnë tekste që i përkasin gjinive të ndryshme dramatike. Zgjedhen shembuj që shprehin dallimin midis komedisë dhe tragjedisë si gjini letrare. Nxënësit diskutojnë për mënyrën e të shprehurit, temën dhe sjelljen e personazheve.
- Nxënësit ndahen në grupe, secili grup i jepet detyrë që të shkruajë një letër elektronike të cilën ua drejtojnë subjekteve të ndryshme: Këshillit të Prindërve, Këshillit të Shkollës, Komunitetit të Nxënësve, një institucioni. Mënyra e të shkruarit mund të hartohet sipas kreativitetit të nxënësve por në përputhje me kërkesat, nevojat dhe interesat e tyre aktuale që lidhen me jetën e tyre shkollore. Secili grup shkruan ashtu si mendon se duhet të duket një letër zyrtare (formale), për një temë të zgjedhur prej tyre. Lihen të punojnë 15 minuta dhe më pas secili grup lexon letrën. Nxënësit nga grupe të ndryshme komentojnë atë që është shkruar, kurse mësimdhënësi/ja e mbikëqyr punën e tyre. Në fund të orës, me ndihmën e mësimdhënësit/es bëjnë një plan të dalë nga diskutimi i përbashkët, i cili do t'u shërbejë për të shkruarit e mëtejshëm të letrave elektronike.
- Nxënësit ndjekin një shembull në tabelë se si është strukturuar një lutje kur duhet t'i drejtohen zyrtarisht dikujt (kujt ia drejtojnë, titullin, nga kush, për çfarë, nënshkrimin, datën, vendin). Më pas u jepet detyrë që të bëjnë një lutje drejtuar Këshillit të Arsimitarëve që të lirohen nga mësimi për shkak të pjesëmarrjes në ndonjë garë. Të gjithë i këmbëjnë lutjet që i kanë shkruar dhe diskutohet për suksesin e asaj që është punuar.
- Nxënësit kanë për detyrë që një herë në çdo gjysmëvjetor të përgatisin një fjalim të shkurtër mbi një temë të zgjedhur vetë, e cila duhet të lidhet ngushtë me interesat dhe preokupimet e tyre: sportin që ushtrojnë, një muzikë të caktuar që dëgjojnë, një libër që u ka lënë mbresa, një personazh publik që u ka ngjallur interes për dikë a për diçka e kështu me radhë. Në fjalim, ata duhet të bëjnë një hyrje, një shpjegim të temës që kanë zgjedhur, një shpjegim/duke dhënë arsyet pse u pëlqen apo nuk u pëlqen gjëja e zgjedhur, çfarë ndjenjash ngjall, përfundimi/synimi i fjalimit. Mësimdhënësi/ja përcakton vëllimin, përkatësisht gjatësinë e fjalimit që duhet të prezantohet.
- Nxënësit kanë për detyrë të përgatisin një fjalim në formë të shkruar për një temë që u e kanë të afërt ose që rrjedh nga një temë e mësuar në lëndën e gjuhës shqipe ose nga ndonjë lëndë tjetër. Tema duhet të shpjegohet, të ilustruhet me fakte dhe të përmbledh një problem. Nxënësit lexojnë para klasës dhe marrin informata kthyesë për atë që lexojnë nga shokët e tyre të klasës: nëse ishin të qartë, nëse parashtruan fakte/argumente dhe nëse e përfshinë si duhet problemin që paralajmëruan në fillim.
- Nxënësve u jepet për detyrë të shkruar ese. Mësimdhënësi/ja vendos rregullat për shkrimin e esesë në tabelë: *“Përcaktoni një hipotezë në lidhje me titullin dhe zhvilloni atë në këtë mënyrë: hyrje - në të cilën ju tërhiqni vëmendjen për problemin për të cilin dëshironi të shkruani përmes dy fjalive të para, ndërsa më pas paraqitni temën për të cilën dëshironi të flisni. Në pjesën kryesore, vendosni disa gjëra të rëndësishme dhe në çdo prezantim, të keni një fjali të parë të qartë dhe më pas vendosni detaje, shembuj që mbështesin temën tuaj. Nga shembujt kaloni në idetë tuaja për temën dhe ngadalë shkoni drejt përfundimit. Në pjesën e fundit, theksoni pikat e rëndësishme të asaj që tashmë është shkruar dhe përfundoni*

me një fjali që ka efekt dhe që mbahet mend". Nxënësit i lexojnë esetë e tyre dhe japin informata kthyesë në përputhje me atë që kanë dëgjuar dhe me rregullat që janë shkruar në tabelë.

- Nxënësit janë ulur në rreth. Në tabelë është vendosur një *"mur me fjalë"*. Mësimdhënësi/ja përcakton se kush fillon i pari. Ai/ajo që fillon duhet të thotë një fjali të thjeshtë që do të përmbajë të paktën një fjalë nga *"muri me fjalë"*. Secili nxënës i ardhshëm shton një fjalë ose fillon një fjali të re të thjeshtë. Loja vazhdon derisa të kenë marrë pjesë të gjithë nxënësit. Më pas nxënësit vazhdojnë të punojnë të pavarur dhe të shkruajnë fjalitë që formuan gjatë lojës. Pjesa e parë e mësimit kur përdorin fjalët nga muri është baza që ata të krijojnë rrëfimin e tyre. Gjatë të shkruarit, ata i kushtojnë vëmendje kompozimit të tekstit të shkruar, përdorin një formë teksti që e zgjedhin vetë.
- Nxënësve u jepet detyrë të bëjnë dialogë drame për tema që lidhen me jetën e përditshme shkollore. Ata i lexojnë ato në çifte dhe gojarisht i japin njëri-tjetrit komente.
- Nxënësit krijojnë vargje me temë atdheu ose dashuria e parë. Ata përdorin mjete shprehëse stilistike gjatë të shkruarit. Të gjithë prezantojnë veprën e tyre poetike. Mësimdhënësi/ja nuk insiston në rimë dhe ritëm, por në sens. Çdo nxënës prezanton mjetet stilistike të shprehjes që përdor në poezinë e tij/saj. Nëse është e nevojshme, mësimdhënësi/ja ndihmon në mënyrë individuale me ide të tilla si: *cilat janë fjalët më të bukura që do të dëshironit të thoni për atdheun ose për simpatinë tuaj...* dhe në përputhje me përgjigjet e marra nga nxënësit, mësimdhënësi/ja me pyetje të tjera udhëzuese, ndihmon në të shprehurit e nxënësve në vargje.
- Nxënësit njihen me bazat e debatit përmes një prezantimi të shkurtër: teza, argumente, kundërgargumente, koha e të folurit. Më pas zgjidhet bashkërisht një temë që është aktuale për debat, për shembull, shoqërimi online dhe socializimi live. Dy ekipe me nga tre nxënës deklarojnë pozicionin e ekipit të tyre, ekipi i dytë i kundërshton. Është e rëndësishme që nxënësit të inkurajohen të paraqesin mendimin e tyre përmes argumenteve. Pas debatit, në të cilin secili anëtar i ekipit ka 3 minuta për prezantimin e tyre të detyrueshëm, diskutohet në klasë se cili ekip ka debatuar më mirë (jo nëse ka qenë e drejtë), pra çfarë argumentesh janë paraqitur. Ora mësimore mund të përsëritet disa herë për tema të ndryshme, derisa të gjithë nxënësit të kenë marrë pjesë në debate.
- Nxënësit krijojnë tema të caktuar. Mësimdhënësi/ja i kushton vëmendje mënyrës se si nxënësit, në krijimet e tyre, përdorin fjalitë e përbëra dhe rregullat drejtshkrimore në lidhje me përdorimin e presjes në secilën prej tyre, njëkohësisht kujdeset që të mos ketë gabime që do të ndikonin mbi drejtshqiptimin ose fjalë të papërshtatshme që nuk janë pjesë e gjuhës standarde shqipe.

Fusha programore: NJOHURI MEDIATIKE**Gjithsej: 10 orë****Rezultatet e të nxënit:***Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:*

1. të shpjegojë se si manipulohet me përmbajtjet mediatike përmes titujve;
2. të kontrollojë besueshmërinë e informacioneve tekstuale dhe vizuale në përmbajtjet mediatike;
3. të krijojë përmbajtje mediatike dhe të shpjegojë se si duhet duhet të shpërndahet me përgjegjësi.

Nxënësi /nxënësja do ta zhvillojë vetëdije:

1. për pasojat nga shpërndarja e papërgjegjshme e përmbajtjeve mediatike.

Përmbajtjet (dhe nocionet/konceptet)	Standardet e vlerësimit:
• Titujt dhe mashtrimet për klikime (klik-bejt)	• Tregon shembuj të titujve manipulues dhe tregues. • Shpjegon (përmes shembujve) se si formulohen titujt e përmbajtjeve mediatike për "gjuajtje" të klikimeve.
• Kontrollimi i besueshmërisë së informacioneve dhe i përmbajtjeve mediatike (verifikimi, besueshmëria, burimi kryesor i informacionit)	• Zbaton vegla dhe aftësi për të verifikuar vërtetësinë e përmbajtjes vizuale. • Zbaton hapat për verifikimin e besueshmërisë së përmbajtjes së dhënë mediatike në mediat tradicionale dhe ato online. • Tregon hapat për verifikimin e besueshmërisë së përmbajtjeve mediatike. • Kontrollon datën e postimit, burimin e informacionit, vërtetësinë e citimeve dhe besueshmërinë e të dhënave/provave në përmbajtjen e mediave në internet për të përcaktuar besueshmërinë e saj. • Përcakton kredibilitetin (besueshmërinë) e burimit të informacionit. • Zbaton vegla të ndryshme online për të verifikuar përmbajtjet në internet.
• Krijimi dhe shpërndarja me përgjegjësi e përmbajtjeve mediatike	• Krijon përmbajtje mediatike: formulon tituj që nuk janë manipulues, përdor burime dhe citate të besueshme dhe ofron të dhëna/prova të sakta. • Shpjegon se çfarë do të thotë shpërndarja me përgjegjësi e informacione përmes rrjeteve sociale.

- Tregon pasojat e mundshme nga papërgjegjshmëria e shpërndarjes së informacioneve.

Shembuj veprimtarish (aktivitetesh):

- Nxënësve u prezantohet shkurtimisht kuptimi i fjalës *clickbait* (*clickbait* = *kurth për klikime*) dhe për çfarë qëllimi *clickbait* përdoret më shpesh në internet, por mund të përdorin edhe videon me titull *Clickbait: Zbulimi i taktikës* (<https://www.youtube.com/watch?v=CjG78-WXH2I>). Më pas nxënësit ndahen në grupe të barabarta që garojnë për të gjetur sa më shumë *clickbait* (kurthe për klikime) në internet në një kohë të caktuar. Secili nxënës, brenda grupit, mund të përdorë telefonin e tij celular për të gjetur dhe për të marrë një pamje nga ekrani (screenshot) të *clickbait*. Secili grup përgatit një video prezantim me gjithë *clickbait* e mbledhura nga anëtarët e grupit, duke u kujdesë që të mos përsëriten të njëjtat (çdo klikim paraqitet vetëm një herë). Grupet kanë 15 minuta për të përfunduar të gjithë detyrën (mbledhja e kurtheve të klikimit + përgatitja e prezantimit). Pas skadimit të kohës, secili grup (njëri pas tjetrit) paraqet prezantimin "e tyre" dhe derisa zgjat prezantimi, në tabelë shkruhen titujt e *klikbejtave* (kurthit) të paraqitur, të përkthyer në gjuhën në të cilën zhvillohet mësimi (në rast të përsëritjes së të njëjtëve tituj, shënohen vetëm frekuenca e lajmit). Pas përfundimit të prezantimeve, fillimisht shpallet grupi fitues dhe më pas hapen disa prej klikbejtave të identifikuar për të zbuluar nëse përmbajtja që do të shfaqet korrespondon me titullin (sa manipulues janë titujt). Në fund, në një diskutim të hapur, nxënësit fillimisht deklarojnë se ku e kanë gjetur *klikbejtin* në internet dhe më pas analizojnë së bashku titujt e shkruar në tabelë me qëllim që të gjejnë se cilët prej tyre janë më të përafërt dhe shpjegojnë se me cilat fjalë konkrete shihet ajo në titull.
- Nxënësit, të ndarë në grupe, krijojnë klikbejt tituj për reklama që janë mjaft tërheqëse për klikime (përdorin fjalë sensacionale ose provokuese). Çdo titull e shkruajnë në fletë më vete. Pas përfundimit të punës, të gjitha fletat grumbullohen. Mësimdhënësi shënon çdo fletë me numra rendorë. Pas çdo fjalie të lexuar, nxënësit e vlerësojnë në një shkallë nga 1-10 (sa janë gjasat që ata të klikojnë në atë link pasi të lexojnë titullin). Pas përcaktimit se cili/cilët titull/tituj konsiderohen më tërheqës, ata së bashku përcaktojnë se cilat fjalë ishin përdorur më shpesh në titujt e ofruar.
- Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup merr një nga fotot vijuese: (1) djalë dhe vajzë të fotografuar nga mbrapa, (2) një yll filmi ose muzike, (3) një makinë e përmbysur në autostradë, (4) porcion me ushqim, (5) vajzë ose djalë i mërziur. Grupet marrin detyrë të shpikin dhe shkurtimisht të përshkruajnë një "tregim" në të cilën do të përdornin foton, dhe më pas të tregojnë dhe të përshkruajnë se si do ta modifikonin foton (duke përmirësuar, shtuar ose hequr ndonjë element) për t'i bindur njerëzit të besojnë tregimet e sajara. Grupet prezantojnë punimet e tyre një nga një dhe shpjegojnë se çfarë donin të arrinin me ndryshimet e bëra. Pas çdo prezantimi, mësuesi, në marrëveshje me nxënësit, shkruan në tabelë se çfarë lloji ndërhyrjeje ofrohet në fotografi:
 - ndryshimi i elementeve në personazhin/objektin qendror të fotografisë (p.sh. të shtojë/fshijë ndonjë pjesë të veshjes, të shtojë/fshijë ndonjë përbërës në ushqim);
 - zëvendësimi i sfondit të fotos (p.sh. djali dhe vajza në vend të plazhit ata janë në klasë);
 - heqja e elementeve përreth fotos (p.sh. fshirja e lotëve nga fytyra e vajzës/djalit);

- të shtojë elemente të tjera përreth në foto (p.sh. të shtojë një person të lënduar pranë makinës së përmbysur ose një personi që kënaqet duke ngrënë ushqim).

Pas prezantimeve të të gjitha grupeve, në një diskutim të hapur, nxënësit shprehin edhe mënyra të tjera që në realitet përdoren për të manipuluar përmbajtjen vizuale (foto dhe videoklipe) dhe për çfarë qëllimi bëhen ato. Më pas, të njëjtave grupe të nxënësve u jepet nga një foto e ndryshme manipuluese (p.sh. ato të dhëna në f. 190-193 ose 202 të Doracakut për trajnues të edukimit mediatik “*Mësojmë të njohim*”, <https://www.irex.org/sites/default/files/Learn%20to%20Discern%20Trainers%20Manual%20%E2%80%93%20N.%20Macedonia%20YouThink.pdf>) dhe u jepet për detyrë të analizojnë dhe të zbulojnë elementet që tregojnë se fotografia nuk është e besueshme, duke shfrytëzuar përvojën nga aktiviteti i mëparshëm kur ata ndërhyjnë në foto. Pas prezantimit punës së bërë nga grupet, nxënësve (individualisht) u kërkohet të tregojnë shembuj të tjerë të përmbajtjeve vizuale të manipuluar (foto dhe videoklipe) që kanë hasur në realitet.

- Nxënësit, të ndarë në grupe, marrin të njëjtat foto të manipuluar në të cilat kanë punuar në aktivitetin e mëparshëm, me detyrë për të kontrolluar besueshmërinë e tyre, me çrast mësimdhënësi/ja prezanton veglat njëra pas tjetrës dhe pas çdo prezantimi nxënësit aplikojnë veglat në të njëjtat fotografi. Mësimdhënësi/ja prezanton mjetet e mëposhtme për të kontrolluar besueshmërinë e përmbajtjeve vizuale të cilët janë të disponueshme në internet (të sqaruara në f. 203-205 të Doracakut për trajnues të edukimit mediatik “*Mësojmë të njohim*”):

- Search Google for image, TinEye ose Yandex – për kërkim të fotografisë origjinale.
- Forensically (<https://29a.ch/photo-forensics/#forensic-magnifier>) në të cilën ka mundësi:
 - Clone detection – për zbulimin e elementeve të shtuara;
 - Error level analysis – për zbulimin e segmenteve që dallohen sipas cilësisë;
 - MetaData – për të parë se kur është bërë fotografia dhe datat kur është edituar;
 - GeoTags – për zbulimin e koordinatave të sakta të vendit ku është krijuar baza e fotografisë.

Pas aplikimit të secilës vegël nxënësit ndajnë njohuritë dhe i përshkruajnë përvojat. Së fundi, diskutohet se si ata mund të verifikojnë edhe vetë besueshmërinë e një përmbajtje vizuale pa përdorur vegla, për të arritur në përfundimin se manipulimi me fotografinë mund të vërehet duke: (a) kontrolluar detajet dhe perspektivën (hije jo përkatëse, mospajtime në këndvështrimin ose ndriçim i pamjaftueshëm); (b) kontrollimi i harmonizimit të cilësisë të të gjithë elementëve në fotografi (anomalitë në dritë, qartësia e disa pjesëve); (c) analiza e kontekstit (nëse koha, vendi dhe mjedisi i paraqitur në fotografi korrespondojnë me kontekstin në të cilin fotografia është e shpërndarë).

- Nxënësit ndahen në gjashtë grupe për të punuar në një projekt të përbashkët. Secili grup fillon të punojë në një nga hapat e mëposhtëm për të verifikuar besueshmërinë e përmbajtjes së medias:
 1. kontrollimi i besueshmërisë së burimit të një përmbajtjeje (nëse autori është i njohur dhe kompetent, respektivisht nëse mediumi ka reputacion për publikimin e informacioneve të vërteta apo të rreme), nëse medium ka seksion të veçantë për *ne/kontakt/përshtypjet tuaja*;
 2. kontrollimi nëse informacioni konfirmohet edhe nga burime të tjera të pavarura;
 3. analiza e kontekstit të përmbajtjes (nëse citimet e përmendura, burimet e informacionit, datat dhe informacionet e tjera përkatëse kanë lidhshmëri, nëse janë logjike dhe të verifikuara).
 4. kontrollimi i besueshmërisë së përmbajtjeve vizuale të përfshira (nëse fotografia përputhet me përmbajtjen);
 5. kontrollimi nëse informacionet (i gjithë ose një pjesë e tij) është publikuar më parë në një kontekst tjetër (kur dhe ku është publikuar);

6. kontrollimi nëse informacionet janë të verifikuara nga web-faqet për verifikimin e fakteve (kontrollues faktesh vendase ose të huaj).

Detyra e nxënësve është që të hulumtojnë hapat "e tyre" në mënyrë që të përgatisin: (a) një video-prezantim që shpjegon se si i zbatuan hapat konkrete, dhe (b) një shembull të lajmeve të rreme (me tekst dhe fotografi ose videoklip), të cilën do t'ua japë grupeve tjera që t'i zbatojnë ato hapa (në koordinim me mësimdhënësin/en). Pas përfundimit të detyrës, grupi që ka punuar në hapin e parë shpjegon hapat "e tyre", pas së cilës grupet e tjera përdorin shembullin për të zbatuar hapat e prezantuar. E njëjta procedurë përsëritet për çdo hap, sipas renditjes së hapave të mësipërm. Pas përfundimit të punës në të gjitha hapat, fillimisht në tabelë përmbledhet rendi i hapave dhe më pas, përmes një diskutimi të hapur, arrihet në përfundimin se zbatimi i hapave fillestarë është më i thjeshtë, por jo gjithmonë ndihmon në zbulimin e gënjeshtërisë së përmbajtjes mediatike që po verifikohet, por hapat e mbetur, nëse zbatohen në mënyrë të vazhdueshme, duhet të tregojnë nëse përmbajtja është e besueshme apo e rreme. Rekomandohet që ky aktiviteti të realizohet të paktën në dy orë mësimore – një orë për të përfunduar me përgatitjen e prezantimit dhe shembullit, dhe orët e tjera për të paraqitur shpjegimin dhe për të përdorur shembujt e zbatimit të hapave.

- Nxënësve, të ndarë në grupe, u jepet detyra të përgatisin një artikull të shkurtër (500-600 fjalë), si për një gazetë shkollore elektronike, për një nga temat e mëposhtme që do të tërheqin: (1) Jeta e kafshëve në kopshtin zoologjik; (2) Respektimi i rregulloreve të vaksinimit të fëmijëve; (3) Rritja e dhunës së bashkëmoshatarëve në shkollat e mesme; (4) Shkrija e akullit polar dhe ndryshimet klimatike globale, dhe (5) Praktikimi i barazisë gjinore në familje. Çdo grup duhet: (a) të formulojë titull për artikullin "e vet" që është tërheqës, por që nuk është manipulues; (b) të përdorë të dhëna të sakta nga burime të besueshme gjatë shkrimit të tekstit dhe (c) të përfshijë citate të besueshme në tekst. Grupet shkruajnë tekstin "e tyre" në kompjuter (mundësisht duke vënë ilustrime përkatëse) dhe pas përfundimit të detyrës e lexojnë atë dhe ua prezantojnë vizualisht të tjerëve. Pas prezantimit, tekstet shpërndahen në Viber dhe/ose publikohen në Facebook. Rekomandohet që ky aktiviteti të realizohet në dy orë mësimore - një orë për të përfunduar me përgatitjen e artikujve dhe ora tjetër për t'i prezantuar dhe shpërndarë ato.
- Nxënësit, të ndarë në grupe, punojnë në të njëjtat tema nga aktiviteti i mëparshëm, por me një detyrë tjetër – në vend të tekstit që kanë përgatitur më parë, të mendojnë një tekst të ri që do të shkruhet në mënyrë që të frikësojë, të sulmojë, të fyejë, të nënçmojë ose të shkaktojë ndonjë lloj dëmi tjetër ndaj ndonjë personi fiktiv ose një kompanie/institucioni/organizate fiktive. Në të njëjtën kohë, teksti duhet të jetë më i shkurtër (200-300 fjalë) dhe të ketë një titull sensacional. Grupet shkruajnë në kompjuter tekstin "e tyre" dhe pasi kryejnë detyrën e lexojnë dhe ua prezantojnë në mënyrë vizuale të tjerëve. Në fund zhvillohet një diskutim i hapur për pyetjet vijuese: (1) *Cilat do të ishin pasojat për personin/kompaninë nëse tekstet e shkruara do të shpërndaheshin përmes rrjeteve sociale?* dhe (2) *Çfarë do të thotë shpërndarja e përgjegjshme nëpërmjet rrjeteve sociale?* për të arritur në përfundimin, se çdo shpërndarje e informacionit që krijohet për të dëmtuar dikë (pavarësisht se kush e krijoi atë) është e papërgjegjshme, siç është e papërgjegjshme shpërndarja e informacioneve të huaja pa verifikim të besueshmërisë së tyre.

GJITHËPËRFSHIRJA, BARAZIA / NDJESHMËRIA GJINORE, INTEGRIMI NDËRKULTUROR DHE NDËRLËNDOR

Mësimdhënësi/mësimdhënësja siguron gjithëpërfshirjen e secilit nxënës në të gjitha aktivitetet që zhvillohen gjatë orës mësimore. Kështu, ai/ajo mundëson që çdo fëmijë të angazhohet në mënyrë njohëse dhe emocionale me anë të qasjeve të duhura metodologjike (individualizim, diferencim, punë në grupe, mbështetjen nga bashkëmoshatarët). Gjatë punës me nxënësit me pengesa në zhvillim zbaton planin arsimor individual (me rezultate të përshtatshme të të nxënës dhe të standardeve për vlerësim) dhe gjithmonë, kur është e mundur, shfrytëzon mbështetjen nga persona të tjerë (asistentë personalë dhe arsimorë, ndërmjetësues arsimorë, mësues vullnetarë dhe profesionistë të shkollave me qendra burimore). Përcjell rregullisht të gjithë nxënësit, veçanërisht ata nga grupet e pambrojtura, që të mund t'i identifikojë me kohë vështirësitë e tyre në të mësuar dhe t'i inkurajojë e t'i përkrahë ata në arritjen e rezultateve të të nxënës.

Gjatë realizimit të aktiviteteve mësimdhënësi/mësimdhënësja trajton njëlloj si djemtë, ashtu edhe vajzat, duke u kujdesur që të mos u ndajë atyre role me stereotipa gjinorë. Gjatë formimit të grupeve të punës, mësimdhënësi/mësimdhënësja përpiqet të sigurojë një balancim të bazuar në gjini. Gjatë përzgjedhjes së materialeve shtesë në mësimdhënie, ai përdor ilustrime dhe shembuj të ndjeshëm në pikëpamje gjinore dhe etnike/kulturore, që nxisin barazinë gjinore, përkatësisht që promovojnë interkulturalizmin.

Gjithmonë, kur është e mundur, gjatë planifikimit dhe realizimit të mësimdhënies, mësimdhënësi/mësimdhënësja përdor integrimin e temave/përmbajtjeve/koncepteve. Integrimi ua mundëson nxënësve të përfshijnë këndvështrime nga lëndët e tjera mësimore në atë që mësojnë në lëndën e gjuhës shqipe dhe kështu të ndërlidhin njohuritë e fushave të ndryshme në një tërësi.

VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE

Për t'ua mundësuar nxënësve t'i arrijnë standardet e pritura të vlerësimit, mësimdhënësi/mësimdhënësja duhet të bëjë vlerësim të përvojave, njohurive dhe aftësive të mëparshme të nxënësve, të ndjek vazhdimisht aktivitetet e nxënësve gjatë mësimdhënies dhe gjatë të nxënës duke mbledhur informacione në lidhje me përparimin e secilit nxënës. Për pjesëmarrjen në aktivitete, nxënësit marrin informacione kthyes të cilat tregojnë nivelin e suksesit gjatë realizimit të aktiviteteve/detyrave dhe jepen udhëzime për përmirësim (vlerësimi formativ). Për këtë qëllim, mësimdhënësi i përcjell dhe vlerëson:

- përgjigjet me gojë për pyetjet e bëra nga mësimdhënësi ose nga nxënësit e tjerë;
- parashtrimin e pyetjeve dhe pjesëmarrjen në diskutime gjatë orës mësimore;
- detyrat e shtëpisë;
- ushtrimet kontrolluese dhe përgjigjet në kontrolle dijesh (teste të shkurtra) që janë pjesë e mësimdhënies;
- pyetjet ese;
- përgatitjen e afisheve/postereve;
- ushtrimet kontrolluese;
- testet e njohurive;
- ditarët refleksiv;
- detyrat dhe veprimtaritë hulumtuese gjatë të cilave nxënësi kryen: mbledhjen e të dhënave, evidentimin, paraqitjen e rezultateve - në mënyrë narrative ose me tabela, me diagrame ose me grafikë dhe prezantimin e tyre;

- punimet praktike (p.sh. të shkruarit / krijimi i teksteve sipas kërkesave të ndryshme, analiza dhe interpretimet e teksteve letrare, analiza gramatikore e tekstit, demonstrime, skema, ilustrime, prezantime etj.);
- raporte të shkruara me të dhëna nga hulumtimet e kryera.

Pas përfundimit të secilës temë, nxënësi merr notë me numër për standardet e arritura të vlerësimit. Vlerësimi sumativ kryhet duke kombinuar rezultatin e arritur nga testet e njohurive me notën e progresit të konstatuar nëpërmjet teknikave të ndryshme të vlerësimit formativ. Në fund të vitit shkollor nxënësi merr notën sumative (përmbledhëse) me numër.

Fillimi i zbatimit të programit mësimor	Viti shkollor 2026/2027	
Institucioni/bartës i programit mësimor	Byroja e Zhvillimit të Arsimit	Биро за развој на образованието
Sipas nenit 30, paragrafi 3 i Ligjit për Arsimin Fillor (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, nr. 161/19, 229/20, 3/25 dhe 74/25), ministrja e Arsimit dhe Shkencës miratoi programin mësimor të lëndës <i>Gjuhë shqipe</i> për klasën VIII. Согласно член 30, став 3 од Законот за основно образование („Службен весник на Република Северна Македонија“ бр. 161/19, 229/20, 3/25 и 74/25) министерката за образование и наука ја донесе наставната програма по предметот <i>Албански јазик</i> за VIII одделение.	бр.12-12084/7 12.9.2025 година	Министерка за образование и наука, проф. д-р Весна Јаневска, с.р.